



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve

“Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Ass. Dr. Rrezeart Galica 

2. Dr. Dorina Arapi 

Prill 2023

Universiteti i Arteve është njohur me DRVJ në datë 20.03.2023 përmes sistemit AMS dhe formë zyrtare me shks Nr prot 32/15 datë 20.03.2023. Universiteti ka përcjell komentet për DRVJ ASCAL në datë 28.03.2023 me shks Nr prot 316/4.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, paraqet si më poshtë mendimet e tij rreth komenteve të paraqitura nga institucioni.

Fillimisht gjejmë rastin të shprehim se:

Departamenti i Arteve të Aplikuara ka në përbërjen e tij një trupë pedagogjike të përbërë nga personalitete nga fusha e arteve, të cilët kanë qenë dhe mbeten protagonistë në zhvillimet e sotme artistike dhe kulturore, jo vetëm në krijimtari, por edhe sa i përket hulumtimit dhe kërkimit artistik e arteve të aplikuara. Disa prej personaliteteve të kulturës shqiptare janë gjithashtu pedagogë të programit, gjë e cila është një pikë e fortë e këtij programi. Përmes diskutimeve të tij me stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ, reflektohej një klimë e mirë bashkëpunimi, mirëkuptimi i ndërsjellë. Ky është faktor i rëndësishëm në mësimdhënie, dhe rrjedhimisht në formimin akademik të studenteve të programit.


Në të njëjtën kohë projektimi dhe zbatimi i një sërë projektesh të rëndësishme si ato me partneritet shqiptar, ashtu edhe ato me mbështetje dhe partneritet ndërkombëtar, ndikojnë në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara dhe të synuara nga departamenti. Gjithashtu, organizimi i një sërë veprimtarish artistike dhe kulturore në universitet, ku studentë dhe pedagogë performojnë së bashku për publikun e pranishëm, ndikon në praktikimin dhe marrjen e përvojës së drejtpërdrejtë në krah të emrave dhe personaliteteve të shquara të artit dhe kulturës shqiptare.

Fakulteti, Departamenti që ofrojnë këto programe dhe FAB kanë lidhur marrëveshje me institucione dhe biznese të ndryshme për praktikat profesionale të studentëve në përfundim të studimeve të tyre. FAB dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara zhvillojnë vazhdimisht aktivitete formuese dhe promovuese në benefit të studentëve, si dhe takime të ndryshme me personalitete të fushave të Artit, gjë që ndikon pozitivisht në formimin e njohurive dhe krijimin e përvojave të reja në krijimtarinë artistike të studentëve.

Në lidhje me raportin Tekstil, Pikturë, dhe Mësuesi, paraqesim komentet si më poshtë:

Fusha 1, standardi 1.1

Në lidhje me këtë koment, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vizitën në institucion, GVJ, merr parasysh se Universiteti i Arteve ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të tij. Në lidhje me statusin e universitetit, GVJ është vënë në dijeni për këtë problematikë, dhe e sheh si diçka që nuk varet nga institucioni, por nga ligjet mbi arsimin dhe institucione si Ministria e Arsimit.. Kjo gjë



paraqitet në raport për të qenë sa më transparent në relacion, por nuk shihet nga GVJ, si një problematikë që rrjedh nga vetë IAL, por instancat më të larta.

Në lidhje më fushën II, standardi 2.4; fusha IV, standardi IV.3:

Në lidhje me këtë koment, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vizitën në institucion, GVJ, merr parasysh se Universiteti i Arteve disponibilitetin, mundësinë dhe angazhimin e institucionit dhe po ashtu të pedagogëve të lëndës, për përmirësimin e azhornimin e literaturës. Është e kuptueshme, që literatura është e pakët në këto fusha, apo të përkthyer në gjuhën shqipe. GVJ ka konstatuar vështirësitë që paraqiten në blerjen e librave për shkak të procedurave ligjore dhe jo për arsye që varen nga institucioni. Duke qenë se GVJ, është një komision më formim dhe edukim artistik, e kupton rëndësinë dhe rolin e padiskutueshëm të pedagogëve në formimin artistik, dhe disponibilitetin e tij për të bërë më të mirën për mësimdhënien.

Në lidhje më fushën II, standardi 2.6,


Në lidhje me këtë koment, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vizitën në institucion, GVJ, merr parasysh se Universiteti i Arteve është një institucion i cili ka një traditë të konsoliduar artistike, administrative dhe mbështetëse ndaj stafit pedagogjik, zhvillimit dhe ngritjes profesionale. Kjo gjë vihet re përsa i përket aktiviteteve të shumta artistike vetjake dhe kolektive të stafit, pranë galerisë së universitetit e cila mbetet një pikë e qëndrueshme dhe me vlerë për institucionin dhe mjedisin artistik në kryeqytet. Rekomandimi i GVJ akoma më tej për mbështetjen e stafit në aktivitete të tilla, bëhet me qëllim vazhdimin më tej të kësaj tradite, si dhe pse jo me botime të stafit apo ekspozita.

Në lidhje më fushën II, standardi 2.7 dhe në fushën III, standardi III.1 :

Në lidhje me këtë konkluzion, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vizitën në institucion, GVJ beson se këto rekomandime për të cilat është dakord dhe IAL, mendojmë se do të ndikojnë pozitivisht në ecurinë e mëtejshme të këtij programi.

Në lidhje më fushën IV, standardi IV.2

Në lidhje me godinën dhe ambientet e universitetit, ashtu siç pohon dhe komenti e raporti i vetë institucionit, FAB plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin teorik dhe atij praktik. Nëpërmjet raportit dhe diskutimet me stafin, GVJ konstaton se rinovimi i godinave, shtimi i tyre është në qëllimin e vetë institucionit dhe prioritet për të. Kjo akoma më tepër duke parë trendin në rritje të regjistrimit të studentëve. GVJ është i ndërgjegjshëm se ky aspekt nuk varet nga institucioni, (i cili ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me organe e institucione të tjera për këtë gjë), por



aspekte të tjera që e superojnë kontekstin institucional. Kjo gjë paraqitet në raport për të qenë sa më transparent në relacion, por nuk shihet nga GVJ, si një problematikë që rrjedh nga vetë IAI.

Në lidhje me fushën IV, standardi IV.4


Në lidhje me sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional, andiministri, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik GVJ se dokumentacioni që posedon ky institucion është krejtësisht në përputhshmëri me aktet ligjore aktuale. Gjatë vizitës së GVJ-së iu prezantua në letër të gjitha regjistrat e nevojshëm në sekretari për nevojat e studentit me rastin e regjistrimit apo të transferimit. Andaj ato vetëm se mund të modernizohen e të krijohen mekanizma që të kryhen online gjithmonë në përputhshmëri me ligjin e aq sa lejohen të kenë qasje në ato dokumente përmes internetit.

Në lidhje me fushën V, standardi V.5

Në lidhje me angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse përfshirë dhe ato këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit caktuar të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. GVJ gjatë vizitës ka konstatuar në bisedë edhe me studentët se janë të përfaqësuar dhe koepojnë me organet e fakultetit nga senati e deri te këshilli i studentëve. Poashtu ishin miratuar dhe rregullore që këtë bashkëpunim me studentët e ngrehin në një nivel edhe më serioz. Bazuar në këtë bashkëpunim kishte dhe arritje me pjesëmarrje në aktivitete artistike të përbashkëta e përveç kësaj edhe organizime të tjera përfshirë sondazhet për të siguruar cilësinë akademike. Edhe në rastet e kontesteve ishte e siguruar transparenca e plotë me rastin e krijimit të komisioneve dhe punës së tyre, ky segment studentëve iu jep plot vetëbesim që procesi mësimor që zhvillohet në UART është kredibil. Këto metoda bashkëpunimi mes tjerash duhet përkojnë edhe me metodologji të avansuar komunikimi në mënyrë që rezultatet dhe suksesi të jetë i prekshëm.

Në lidhje me fushën VI, standardi VI.5

Në lidhje me rolet e rëndësishme të cilat kanë për qëllim sigurimin e cilësisë akademike në këtë rast rol të posaçëm luan dhe Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, si dhe Sektori i TI, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me përgjigjet e pyetësorëve. Bazuar në këto pastaj rekomandimet janë të rëndësishme në përmirësimin e pjesës së cilësisë akademike. Këtu ka shumë rëndësi dhe sa më shpejt të krijohet Njësia permanente për Sigurimin e Cilësisë në këtë Institucion e cila duhet të jetë në harmoni e në përputhje me Statutin dhe Organigramën e miratuar nga Ministria e Arsimit



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mesuesi” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve UART
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arteve të Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve Pikturë Grafikë dhe Mësuesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhrit të MASR Nr. 821, datë 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2019 – 2020 PAE 2 Prof. Asc. 3 As. Lektor 1 Prof. Asc.Dr 5 Doktor 1 Doc. Doktor PAK 3 As. Lektor 2 Doktor 1 Prof.Asc.Dr Viti akademik 2020 – 2021 PAE 2 Prof. Asc. 3 As. Lektor 1 Prof. Asc.Dr 5 Doktor 1 Doc. Doktor PAK

		3 As. Lektor 2 Doktor 1 Prof.Asc.Dr Viti akademik 2021 – 2022 PAE 2 Prof. Asc. 3 As. Lektor 1 Prof. Asc.Dr 5 Doktor 1 Doc. Doktor PAK 3 As. Lektor 2 Doktor 1 Prof.Asc.Dr
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2021 – 2022 22 studente
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi , ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, në Fakultetin e Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve.

Ky program studimi u riorganizua ashtu si dhe gjithë programet e tjera të ciklit të dytë në UART, në programe studimi në fushën e mësuesisë, sipas Urdhrit të MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve.

Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi i cili ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, pjesë e Fakultetit të Arteve të Bukura, ndërthuret ne kurrikulen e tij lëndë artistike me teorike.

Universiteti i Arteve, ka si mision:

- ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës;
- zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
- formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
- thellimin e kualifikimit profesional e artistik dhe shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës;
- kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;
- Ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Studentët e diplomuar në fund të diplomimit mund të punësohen si në sektorin publik, e po ashtu dhe privat, me profesione si më poshtë:

1. Kurator imazhi
2. Interior Dizajner
3. Produkt dizajner
4. Grafik Designer
5. Studiues arti
6. Punonjës didaktik në sistemin arsimor për edukimin në artet pamore
7. Artist i lirë

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Mbas aplikimit për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", të Universitetit të Arteve dhe Urdhërit nga ASCAL për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi u përcaktuan edhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm: Prof. ass. dr. Rrezeart Galica dhe Dr. Dorina Arapi, si dhe koordinatores teknike të ASCAL, Anilda Beqiraj.

Fazat e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", janë paraqitur si më poshtë:

Grupi i punës së vlerësimit të jashtëm bëri vlerësimin mbi bazë dokumentacioni të paraqitur nga Institucioni aplikues, Universitetit të Arteve.

1. Aprovimi i agjendës së vizitës në IAL u bë ndërmjet dy anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe koordinatores teknike të ASCAL, Anilda Beqiraj;
2. Vizita në institucion u krye në datat 14 dhe 15 dhjetor 2022, sipas përcaktimit në agjendë. Grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi me përpikmëri takimet e caktuara sipas agjendës.

Ditën e parë, më datë 14 dhjetor 2022 u realizuan:

- Takimi me Dekanin e Fakultetit të Arteve të Aplikuara
- Përgjegjësin e Departamentit të Arteve të Aplikuara;
- Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
- Takim me Përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrës së kurikulave;
- Takim me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Takimi përmbyllës i ditës së parë.

Ditën e dytë, më datë 15 dhjetor 2022 u realizuan:

- Takim me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore;
- Takim me studentët e këtij program studimi;
- Takim me përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.
- Vizitë në sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë.
- Takimi përmbyllës me Përgjegjësin e Departamentit

3. Hartimi i Draft raportit të vlerësimit të jashtëm dhe dërgimi i tij në Institucion.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Arteve është themeluar në vitin 1966, fillimisht si Instituti i Lartë i Arteve, dhe më 1990, me ndryshimet në sistemin arsimor, Instituti i Lartë i Arteve u emërtua "Akademia e Arteve". Me VKM nr. 234, datë 23.03.2011, mbi këtë bazë, u krijua Universiteti i Arteve, duke ruajtur të pandryshuar strukturën e Fakulteteve. Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni se programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, që ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara në Fakultetin e Arteve të Bukura, nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Ky institucion, me një trashëgimi institucionale mbi 60 vjecare, ruan dhe konsolidon traditën artistike dhe vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i studimit i aprovuara nga MASR reflekton ofertën akademike në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit. Për tu përafuar sa më shumë me tregun e punës, programi i studimit të u riorganizua duke përfshirë dhe në fushën e mësuesisë, e cili u krye, sipas Urdhrit të MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve". Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve. http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=6&niveli=38 Evidencë. Nr.5.2. Urdhrit të MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve. Evidencë. Nr.7 Statuti i UART, Evidencë. Nr.12. Rregullorja e ciklit të II të studimit, Evidencë. Nr.11. Rregullorja e Njësisë Kryesore Evidencë. Nr.13. Rregullorja e Programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni e ka hartuar programin e studimit, në përputhje me misionin e institucionit. Misioni i programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi përputhet me qëllimet dhe misionin e UART. Qëllimi kryesor i tij është: <ul style="list-style-type: none">• të ofrojë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese e artistike/kërkimore shkencore në fushën e artit dhe të kulturës mbështetur mbi kërkesat për një mësimdhënie cilësore në Shqipëri e përshtatje me kërkesat e tregut të punës,• të thellojë kualifikimin e veprimtarive krijuese e artistike-


	<p>kërkimore shkencore në fushën e artit dhe të kulturës të studentit, në fushën e mësuesisë dhe edukimit artistik.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=6&niveli=38</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p> <p>Evidencë. Nr.2. Vendim nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi ofrohet në përshtatje me planin strategjik të UART për vitin 2018-2025, i cili është miratuar me VBA Nr. 15/1, datë 24.10.2017 “Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025”</p> <p>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015 dhe gjithë kuadrin nënligjor në zbatim të këtij ligji, në VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UART, Rregulloren e UART, Rregulloren e njësisë kryesore, Rregulloren e cikleve të studimit si dhe një sërë aktesh rregullatorë të tjera të UART, të cilat përbëjnë bazën ligjore të funksionimit e mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore, artistike/kërkimore e shkencore si dhe administrative të UART. Programi i studimit bazohet në vizionin strategjik për integrimin rajonal dhe global.</p> <p>Evidencë Nr.14. Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025”</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=660&niveli=73</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi mbështetet në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Arteve, <i>Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020</i> (https://ëëë.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim), në disa parashikime të Draft Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/).</p> <p>Në përputhje me strategjitë e parashikuara në nivel kombëtar dhe ato në nivel ndërkombëtar, programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është konceptuar për tu përshtatur sa më shumë me tregun e punës, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët e mundshëm, dhe duke zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistiko- shkencor me Universitete dhe Institucione në Evropë duke ofruar mundësi ndërkombëtarizimi.</p> <p>Evidenca. Nr. 7. Statuti i UART</p> <p>Evidenca. 45. 1. Parashikimi i kuotave të pranimit, VSA . 17, dt. 10.03. 2022</p> <p>Evidenca. 5.2 Urdhri i MAS Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve”</p> <p>Evidencë. Nr.19. Marrëveshjet ndërmjet institucioneve të artit në Shqipëri.</p> <p>Evidencë. Nr.17-18 Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në vend.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=1090</p>

<p>Konkluzione</p>	<p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1091</p> <p>GVJ konstaton se Universiteti i Arteve ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>GVJ konstaton se Universiteti i Arteve ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës e bisedave në institucion, u konstatua se një pikë e cila kërkon reflektim, është statusi i universitetit. Duke kuptuar vetë natyrën e këtij universiteti, ky program ashtu si dhe programet e tjera të FAB, kërkojnë një bazë të fortë njohurive artistike dhe atyre shkencore, çka nënkupton se nevojitet një staf specifik. Në vitet e kaluara stafi akademik i UA, i konvertohej aktiviteti artistik në tituj akademik si (Prof. Asoc., Prof.), aspekt që sot Ligji për Arsimin e Lartë nuk e mundëson e vështirëson kualifikimin e stafit me titujt akademik. Ligji për Arsimin e ri aktual, si edhe marrja me statusit të veçantë të UA me VKM 145, ende nuk e ka zgjidhur këtë problematikë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura ka mbi 60 vjet që ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit të lartë dhe demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura njerëzore në programin e studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky fakultet ka personel akademik të kualifikuar dhe infrastrukturë funksionale për realizimin të këtij programi studimi.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv, në nivel fakulteti, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5 Profesorë, • 1 Profesor i Asociuar, Dr. • 4 Profesorë të Asociuar, • 7 Lektor me gradën Dr./PhD, dhe nga • 20 Asistent Lektorë. <p>Ndërsa Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Profesor • 2 Profesor i Asociuar, Dr. • 2 Lektorë me gradë Dr., • 12 Asistent Lektorë. <p>Në programin e studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total 9 staf</p>

	<p>akademik, prej të cilëve 2 me titullin Prof. Asoc, 0 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 7 Asistent Lektor.</p> <p>Evidencë. Nr.16. Tre tabelat e stafit akademik për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</p> <p>http://uart.edu.al/media/2021%20-%20FAB%20PERSONEL%20AKADEMIK.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, është fusha e Grafikës, e cila është në përputhje me fushën studimore akademike artistike/kërkimore dhe shkencore të njësisë kryesore, Fakultetit të Arteve të Bukura, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Fusha specifike e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, është në përputhje me fushën akademike artistike/kërkimore e shkencore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi është në përputhje me Kodin e Cilësisë së AL, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit "Master i Arteve"; Manualit për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit 2017; si dhe Udhëzuesit dhe Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines-ESG 2015, https://ëëë.enqa.eu/ëp-content/uploads/filebase/esg/ESG%20in%20Albanian by%20KAA.pdf)</p> <p>Evidencë. 4. VKM Nr.824, dt 24.12.2021 Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, është fusha e grafikës. Ajo është në përputhje me fushën akademike e studimore të njësisë bazë, Departamentit të Arteve të Aplikuara.</p> <p>Evidencë. Nr.16. 1 Tabelat e stafit akademik sipas lëndëve për programin e studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program studimi nuk i referohet këtij kriteri, pasi është Master i Arteve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në</p>	<p>Universiteti i Arteve nuk ofron trajnime profesionale apo programe studimi të ciklit të vazhduar.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



bashkërendim me punëdhënësit.			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë, përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p> <p><i>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë, përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p> <p><i>Programi i Studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi ka një histori të saj, një strukturë didaktike tradicionale e ndërtuar nga profesionistët më të mirë në vend që në vitet '70, dhe që aktualisht është përshtatur me kërkesat e arsimit dhe kulturës bashkëkohore me disa nga emrat më të rëndësishëm të skenës së artit në vend, duke e kthyer kështu atë në institucion arsimor unik në rang kombëtar.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në Fakultetin e Arteve të Bukura, në fillim të çdo viti akademik, njësitë kryesore diskutojnë problematikat, zgjidhjet dhe prioritetet e çdo njësie bazë në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, ngarkesës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ.</p> <p>Në vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni se departamenti i Arteve të Aplikuara, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi ka siguruar dhe siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda Universitetit, ku evidentohen personeli akademik, e strukturat mbështetëse si:</p> <p>Sekretaria mësimore Biblioteka Drejtoria e Burimeve Njerëzore Informacion/Protokoll/Arkiv Sektori Mësimor i Kurrikulës Këshillimit të Karrierës Informimit të Studentëve dhe Alumni Sektori i Statistikës Sektori i Teknologjisë së Informacionit Sektori i Sallave dhe Shërbimeve Mbështetëse Sektori Juridik,</p> <p>Evidencë. Nr.15. Raporti vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve,	Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik/shkencor me disa Universitete dhe

<p>institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucione në Evropë që janë realizuar e formalizuar në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe apo edhe jashtë tyre. Universitetet, Akademitë me të cilat bashkëpunon institucioni janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshje Kuadër ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë; • Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Conservatoire national supérieur de musique et de danse de Paris dhe Universitetit të Arteve; • Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim; Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit në Shkup CINEDAYS; • Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, China; • Protokoll i Bashkëpunimit të Universitetit të Arteve të Bukura “Mimar Sinan” dhe Universitetit të Arteve, Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës; • Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër; • Shkollën kombëtare artistike “Jordan Misja”. <p>Këto bashkëpunime mundësojnë jo vetëm ndërkombëtarizimin e programit të studimit, por dhe ndikojnë pozitivisht në mobilitetin akademik dhe të studentëve. UART ka marrë pjesë rregullisht në programin e mëhershëm Tempus, dhe vitet e fundit ka disa marrëveshje partneriteti në kuadër të projektit Erasmus+ mbështetur financiarisht nga BE.</p> <p>Evidencë. Nr. 17-20. UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni se për realizimin e praktikave mësimore të programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe si dhe ato të Zyrave Vendore Arsimore.</p> <p>Pjesa më e madhe e studentëve të këtij programi, i ka kryer praktikat mësimore pranë shkollave të mesme, të cilat kanë mundësuar zbatimin e teorisë në praktikë, dhe konkretizimin e dijeve të përfuara në këtë program.</p> <p>Evidencë. Nr.19. Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Arteve të Bukura me Institucionet arsimore ZVA-të</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Arteve të Aplikuara, në bashkëpunim edhe Dekanatin e Fakultetit të Arteve të Bukura, në mënyrë periodike, analizon përftimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit, dhe harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit dhe të objektivave të këtij programi studimi.</p>


realizimit të programit të studimit.	<i>Evidencë. Nr. 20. Raport mbi marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucionika ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. .			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimi Master i Arteve në: Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në katërgoritë: A-Lëndë Bazë; B-Lëndë Karakterizuese; C-Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese; D-Lëndë Plotësuese; E-Detyrime Përmbyllëse. Kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS. <i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit Master i Arteve në Master i Arteve në Pikturë Grafikë</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në	Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se realizimi i programit mësimor mbështetet në metodat e mësimdhënies që venë theksin tek studenti, duke i ofruar atyre koncepte e njohuri të përparuara dhe shprehje praktike në fushën e artit dhe edukimit. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies, detyrave të kursit, praktikave profesionale të studentëve jashtë universitetit synohet që t'u jepet studentëve njohuri të përparuara akademike në artin pamor edhe në fushën e mësuesisë. Disa nga lëndët artistike e profesionale në këtë program janë: Grafikë, Dizanj Grafik,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>dhe Teknikat e Grafikës. <i>Evidencë. Nr. 22. Kurrikulat e programit Master i Arteve në Master i Arteve në Pikturë Grafikë</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi studimi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” e ndryshuar.</p> <p>Në këtë program studenti merr :</p> <ul style="list-style-type: none"> • 24 kredite për lëndët e kategorinë A, • 44 kredite për lëndët e kategorisë B, • 36 kredite për lëndët e kategorisë C, • 9 kredite për lëndët e kategorisë D, dhe • 24 kredite për detyrimin përmbyllës që është kategoria E, e cila është diploma. <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite.</p> <p>Programi i studimit përcakton ngarkesën në kredite të dedikuara për realizimin e praktikës profesionale, bazuar në është ndërtuar mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe VKM nr.41, datë 24.01.2018 “ për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Praktika mësimore parashikohet si pjesë e planit mësimor dhe përmban një numër kreditesh të caktuara (3 kredite) ose (75 orë) dhe studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen në Institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti përkatës. Cdo hap i zhvillimit të praktikës është parashikuar në rregulloren e përgjithshme, dhe në rregulloren e fakultetit.</p> <p><i>Evidencë 4: Rregullore Mësimore e UART, Kreu VII, neni 29, pika 1,2,3, 4,5,6</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.5: Rregullore Mësimore FAB, Kreu IV, Neni 38, neni 39</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit të studimit Master i Arteve në Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë me kohë të plotë “Master i Arteve në Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi” me njohuri të thelluara artistike-shkencore-teorike dhe praktike sipas drejtimin përkatës, trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda specialitetit, arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Programet e studimit në ciklin e dytë janë programe universitare të formimit artistik të cilat ofrojnë edhe studime në fushën e</p>

<p>lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>mësuesisë, i mundëson studentëve të drejtën për punësim, si mësimdhënës në lëndët e artit, pranë institucioneve të arsimit parashkollor, ciklit të ulët dhe të ciklit të mesëm.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.13. Rregullorja e programit të studimit programit të studimit Master i Arteve në Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë përfshijnë edhe fushën mësuesisë dhe janë të organizuara me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, në sistemin e studimeve me kohë të plotë (60 kredite për çdo vit akademik).</p> <p>Këto programe përmbajnë 25% të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik të shprehura si më poshtë:</p> <p>Kategoria A-Lëndë Bazë, 28 ECTS, (në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 24 ECTS:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologji e mësimdhënies – 6 ECTS. • Teoritë e të nxënies & Menaxhimi Klasës – 6 ECTS • Vlerësimi në Arsim – 4 ECTS • Zhvillim Kurrikulës – 4 ECTS • Psikologji Zhvillimi Moshave – 4 ECTS <p>Kategoria D- Lëndë me Zgjedhje dhe Lëndë Plotësuese, 14 ECTS, (në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 6 ECTS:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Praktikë Mësimore – 6 ECTS <p>Në total lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik përmbajnë 30 ECTS, pra 25% të krediteve, në këtë drejtim.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 21 Plani mësimor dhe rregullorja mësimore për programin e studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi.</i></p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti i Arteve, ndjek politikën për pranimin e studentëve, që bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe prioritetet e tre Fakulteteve të Universitetit të Arteve, duke vlerësuar kapacitetet e mundshme për çdo vit akademik.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në Universitetin e Arteve, pranimi i studentëve kryhet nëpërmjet konkurseve të pranimit, kriteret e të cilave hartohen nga Departamentet, miratohen në Senatën Akademik të UART, dhe dërgohen në MAS. Ministria e Arsimit dhe Sportit, miraton kuotat e dërguara nga UART, dhe nxjerr Udhëzimin përkatës për afatet dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit mbi bazën e rregulloreve dhe kriterëve të UART për këtë proces. Me Vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen tarifat e shkollimit për secilin program studimi të ofruar në UART.</p> <p>Te gjitha këto hapa e procedura, pasqyrohen dhe në faqen zyrtare online, të institucionit.</p> <p>Universiteti i Arteve, ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Bachelor:</p> <p>Në vitin 2020-2021 - 3 studentë me aftësi ndryshe.</p> <p>Në vitin 2019-2020 - 2 studentë me aftësi ndryshe.</p>

	<p>Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Master: Në vitin 2019-2020 kemi pasur 1 student me aftësi ndryshe. Për studentët që vijnë nga shtresa sociale "Rome/Balkano-Egjiptiane", UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik</p> <p>Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Bachelor: Në vitin 2020-2021 - 1 studentë rom.</p> <p>Evidencë. Nr. 24. Konkurent, fitues dhe Udhëzim-nr.17-datë-30.7.2019 Për përjashtimin e nga pagesa të studentëve; Romë/Balkano –Egjiptianë. http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=135&niveli=78</p>		
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel,	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Arteve të Aplikuara nuk ofron programe të Ciklit të Dytë Master në të njëjtën fushë studimi si dhe me të njëjtën emërtesë.		
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike me anë të VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë"		
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Arteve të Aplikuara nuk ofron programe të Ciklit të Dytë Master midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë vendas apo të huaj.		
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e	Universiteti i arteve përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore të cilat përbëhen secila nga njësi bazë dhe struktura të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ. UART respekton Ligjin e Arsimit të Lartë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al



përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

80/2014 legjislacionin në fuqi si edhe përcaktimet statutore. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me objektivat e tij akademik dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Fakulteti organizohet në jo më pak se tre njësi bazë, ku së paku dy prej të cilave janë departamente. Funkcionet e tyre përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga:

- Departamenti i Arteve të Aplikuara
- Departamenti i Pikturës
- Departamenti i Skulpturës

Për Fakultetin e Arteve të Bukura, numri i stafit akademik me kohë të plotë i ndarë sipas Departamenteve paraqitet si më poshtë: 2020-2021

Fakulteti i Arteve të Bukura – **37 pedagogë**

- Departamenti i Arteve të Aplikuara – **15 pedagogë/**
- Departamenti i Pikturës – **15 pedagogë**
- Departamenti i Skulpturës – **7 pedagogë**

Kualifikimi i pedagogëve në departamentin e Arteve të Aplikuara:

Prof. 2 Pedagogë

Prof. Asoc. Dr. 1 Pedagogë

Prof. Asoc. 1 Pedagogë

Lektor Dr. 1 Pedagogë

As. Lek 10 Pedagogë

Numri i pedagogëve me kohë të pjesshme paraqitet si më poshtë:

- Departamenti i Arteve të Aplikuara – 6 pedagogë/
- Departamenti i Pikturës – 9 pedagogë
- Departamenti i Skulpturës – 2 pedagogë

Viti akademik 2019 – 2020

PAE

2 Prof. Asc.

3 As. Lektor

1 Prof. Asc. Dr

5 Doktor

1 Doc. Doktor

PAK

3 As. Lektor

2 Doktor

1 Prof. Asc. Dr

Viti akademik 2020 – 2021

PAE

2 Prof. Asc.

3 As. Lektor

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>1 Prof. Asc.Dr 5 Doktor 1 Doc. Doktor PAK 3 As. Lektor 2 Doktor 1 Prof.Asc.Dr</p> <p>Viti akademik 2021 – 2022 PAE 2 Prof. Asc. 3 As. Lektor 1 Prof. Asc.Dr 5 Doktor 1 Doc. Doktor PAK 3 As. Lektor 2 Doktor 1 Prof.Asc.Dr</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1 Ligji për arsimin e lartë 80/2015</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidenca nr. 16. Mbi numrin e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme dhe e kualifikimit të tyre.</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=12&niveli=99</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik/shkencor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit, ku bëjnë pjesë dhe laborantët e teknikët. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, artistike dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UART në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Neni nr.17.</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni nr. 69, 70.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara është organizuar në grupe mësimore. Përgjegjësi i grupit mësimor është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin programit në përputhje me objektivat e tij. Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni se pranë njësisë kryesore/bazë, përgjegjëse për Programin e studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është caktuar një koordinator i programit të studimit, që është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1. Ligji i arsimit të lartë 80/2015 neni nr. 25, pika</i></p>

tij.	5 <i>Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Neni nr.15, 16</i> <i>Evidencë. Nr. 27. Vendimi i dekanatit të Fakultetit të Arteve të Bukura mbi emrimin e kryetarëve të grupeve mësimore</i>			
Konkluzione	<i>GVJ se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Programi i studimit Masteri Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është një program i bazuar në punën praktike (studio/ atelier), i cili mbështetet nga një kornizë teorike si në fushën përkatëse, specifikisht të grafikës, por dhe në fushën e mësuesisë.</p> <p>Programit të studimit Master i Arteve në Ateliein në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, nëpërmjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, nëpërmjet :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Praktikës e projektet individuale. -Praktikë e avancuar e realizimi i projekteve në laborator. -Punë teorike, -Praktikë mësimore, <p>Mësimdhënia kryhet nëpërmjet temave specifike, leksioneve teorike, si dhe punëve në laborator, duke ndjekur aktivitete me tema të caktuara, të cilat gërshetohen nëpërmjet punës në atelie, punës në laborator, dhe punës së pavarur.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullore e Prog. Stud. Neni Neni 8 Përmbajtja e programit të studimit</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i studimi Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.1 2018, udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Sipas Planit mësimor ngarkesa totale vjetore për 120 ECTS është 3275 orë të shpërndara (brenda dhe jashtë klase), nga të cilat 1710 orë në auditor dhe 1565 orë punë individuale.</p> <p>Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përcaktohet në planin mësimor të ndarë në vite të propozuar nga Departamenti i Arteve të Aplikuara dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Senati Akademik në UART. Kompetencat dhe objektivat formues të çdo moduli dhe lëndë, pjesë e kurrikulës mësimore të programit të studimit, parashikohen në syllabuset respektive. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme nga A në E:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ A. Lëndë bazë; ▪ B. Lëndë karakterizuese; ▪ C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; ▪ D. Lëndë plotësuese; ▪ E. Detyrime përmbyllëse. <p>Veprimtaritë formuese janë:</p> <p>a) të detyrueshme;</p> <p>b) të zgjedhura nga vetë studentët.</p> <p>Orë individuale në auditor ato zënë rreth 525 orë, ndërsa orë individuale pune 575; për një total prej 1100 orësh. Programi përmban 120 kredite, me kohëzgjatje normale dy vite akademike.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018,</i> <i>Evidenca. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit të studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi"</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=660&niveli=73</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve në programin e studimit me kohë të plotë "Master i Arteve në Pikturë Grafikë Mësuesi" bëhet me konkurs. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteret e pranimit të kandidatëve në këtë program përcaktohen nga Departamenti i Arteve të Aplikuara dhe bëhen publike nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura, pasi miratohen nga Senati akademik i UART. Përzgjedhja e studentëve fitues bëhet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura, në bazë të kriterëve të paracaktuara për pranimin në këtë program studimi.</p> <p>Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të UART dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore. Sipas kuotave të miratuara, UART mundëson njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 90, 91 92, 93, 114</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=133&niveli=75</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi , përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara referuar VKM 41, dt. 24.01.2018 , i ndryshuar. Në planin mësimor të programit të studimit si dhe në secilin syllabus paraqiten informacionet e nevojshme për seminarët apo orët e laboratorit, të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset rishikohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse.</p> <p>Gjithashtu programi i studimit, përmban informacionet e nevojshme për</p>

	<p>praktikat, ku cdo student ka dosjen e tij personale të praktikës, si dhe udhëzuesin e praktikave si dhe syllabusin e saj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore për Prog. Stud.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. VKM nr.41 datë 24.01.2018 i ndryshuar</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e Programit të studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi , është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Ashtu sic përmendëm dhe më sipër, ky program lindi si një nevojë për tu me tregun e punës, ku detyrimisht dhe kurrikula e programit u konceptua në mënyrë të atillë që studentit ti ofrohet si njohuri artistike, dhe po aq pedagogjike.</p> <p>Përditësimet e programit, vijnë në mënyra të ndryshme, si në bazë të shkëmbimit të eksperiencave gjatë mobilitetet, me kontaktet me artistë vendas e të huaj, apo sugjerimet dhe rekomandimet e ndryshme që vijnë nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Në mbledhjet e Departamentit të Arteve të Aplikuara, si njësi bazë e Fakultetit të Arteve të Bukura, kryhen diskutime rreth mundësive të përmirësimit të programit të studimit. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, konsultohen midis anëtarëve të departamentit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Ne fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet apo përmirësimet e mundshme dhe arkivohet dosja e plotë në gjuhët shqip.</p> <p>Në lidhje me këtë, në bazë të kërkesës të inicuar nga departamenti, në programin e studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi në Grupin e Disiplinave të lëndëve karakterizuese (B) u shtua lënda “Estetika dhe dijeberja e veshjeve popullore” me 45 orë dhe 2 ECTS, nga të cilat 30 orë janë në vitin e parë dhe 15 orë në vitin e dytë. Ky ndryshim erdhi si një domosdoshmëri e rishikimit të kurrikulës, duke u nisur nga nevojat e tregut të punës, mbi vlerësimin e rjetëzimin e veshjeve tradicionale dhe studimit të tyre.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. VKM Nr.185, datë 25.03.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.01.2018” shkronja c e pikës 2.9</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 48. 4 Procesverbal i një mbledhje Departamenti</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja</p>	<p>Lëndët e programit janë konceptuar që studentët të zhvillojnë aftësi të</p>

<p>e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>mëtejshme në fushën e kërkimit artistiko – shkencor, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe politikave e strategjive kombëtare mbi arsimin. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe akteve nënligjore, që mundëson thellimin e njohurive dhe aftësitë për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve, vecanërisht në fushën e mësuesisë me qasje artistike, gjë që plotësohet me zhvillimin e praktikës në institucione arsimore të shkollave të mesme.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. Shtojca 1 e VKM 41 datë 24.01.2018</i> <i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit</i> <i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në programin e studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi , lëndët/modulet, të shpërndara në vite e semestra, mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor, si dhe gjithashtu programi i mundëson të diplomuarve të vazhdojnë studimet në ciklin e tretë. Organizimi i programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, është hartuar duke u konsultuar/konsideruar programe të ngjashme ndërkombëtare si dhe përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve [ECTS]. Një kredit përkon me 25 orë punë të studentit, ku përfshihet edhe koha e orëve individuale të studimit. Ngarkesa vjetore e një studenti, që ndjek këtë program studimi është 60 kredite.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, neni 2</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Kurrikula e programit është organizuar në mënyrë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të balancuar përgjatë katër semestrave akademik dhe të sigurojë aftësi profesionale artistike dhe formim mbi fushën e mësuesisë. Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë e cila mundësohet dhe nga ndarja e informacionit, shkëmbimi i stafik akademik, traditë prej disa dekadash që institucioni trashëgon, si dhe nga aktivitete të shpeshta që zhvillohen me artistë vendas e të huaj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 22. Kurrikula 2022 Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A - ja deri te E - ja . Në këtë program studimi, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë transferim të studimeve. Në këtë program studimi, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë mobilitet të tyre në kuadër të projekteve si Erasmus +.</p> <p><i>Evidenca. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore në Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i> <i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për</p>	<p>Syllabuset e lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar, i rishikuar ku pasqyrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pasqyra informative e lëndës,

<p>marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • rezultatet e të nxënit, • konceptet themelore, • temat e detajuara të lëndës, • format e kontrollit të dijeve, • frekuentimi, • kontrolli i vazhdueshëm, • literatura • vërejtje përfundimtare nga pedagogu <p>Departamenti i Arteve të Aplikuara, analizon performancën duke u bazuar në ecurinë e programeve të studimeve dhe përfshijnë në to mendimin dhe opinionin e pedagogëve, por edhe të studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve.</p> <p>Evidenca. Nr. 28. Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p>						
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi garanton dhe është në përputhje të plotë me përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi në përputhje dhe në koherencë me objektivat kryesore të programit të studimit.</p> <p>Evidencë. Nr. 29. Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi Evidencë. Nr. 7 Statuti i UART neni 93.</p>						
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë në institucioneve artistike në rajon dhe ato ndërkombëtare.</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit. Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 106 Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pavarësisht se departamenti dhe institucioni synojnë dhe e kanë të përfshirë në planin strategjik të tyre, përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet literaturës të azhornuar të 5 viteve të fundit, GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme të blerjes së literaturës që paraqitet sipas kërkesave të stafit pedagogjik, në bazë të fushës përkatëse. Gjatë vizitës në institucion, në bazë të diskutimeve të zhvilluara me stafin, blerja e literaturës në disa raste, nuk kishte qenë e mundur, gjë që ndikohet dhe diktohet nga procedurat ligjore të blerjes së librave.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="518 1601 734 1680">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="734 1601 925 1680">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="925 1601 1141 1680">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="518 1680 734 1724"></td> <td data-bbox="734 1680 925 1724"></td> <td data-bbox="925 1680 1141 1724">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.5
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura, ashtu si dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara zhvillojnë aktivitete konsultative, me qëllim përshtatjen e programit të studimit me tregun e punës, ku si rrjedhojë pasoi dhe riorganizimi i studimit të ciklit të dyë u në fushën e mësuesisë. Rishikimi i kurrikulës u realizua duke pasur parasysh një sërë kërkesash të tregut artistik, si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punën. Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, i cili dhe përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky process në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik, si dhe për ngarkesat mësimore të miratuara. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit, ngritjen e komisioneve të posacme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me sektorë të ndryshëm për përmirësimet e programeve, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 33, Projektet artistike të Prog të studimit.</i> <i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni dhe konkretisht Fakulteti i Arteve të Bukura, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), duke ndjekur ecurinë, punësimin, arritjet etj. Fakulteti i Arteve të Bukura mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre në bashkëpunim edhe me Sektorin mësimor dhe organizon aktivitete të dedikuara për ALUMNI. UART, mban kontakte të herë pas herëshme dhe të vazhdueshme me ish të diplomuarit e Universitetit. Për këtë arsye propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të mirëpritura, aty ku është parë e mundshme dhe reale, apo me vlerë për programin dhe studentët pasardhës.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 33. Pjesë nga aktivitetet artistike mes pedagogëve të FAB, studentëve aktualë dhe ish studentëve.</i> http://uart.edu.al/index.php?page=fage&id=705&niveli=71</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura dhe konkretisht Departamenti i Arteve të Aplikuara, në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, ky program studimi përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në bazë të nevojave dhe sfidave të reja të tregut artistik. Departamenti por edhe nga stafi akademik i këtij mbajnë kontakte të vazhdueshme me stafin e mësuesve të arsimit të mesëm të profilizuar si: Liceun Artistik Tiranë, me shkollat e tjera të mesme artistike në vend, por edhe me shkolla të tjera të mesme të përgjithshme në vend, të cilat janë burimi kryesor i Fakultetit të Arteve të Bukura me nxënësit e tyre sot dhe nesër me Studentët e këtij fakulteti.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 19. Lista e bashkëpunimeve kombëtare.</i> <i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti i Arteve nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përcaktuar	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.6
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, i ka përcaktuara prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit artistiko-shkencorë në përputhje me objektivat madhore të UART, ashtu sic vihet re në planin mësimor i cili është konceptuar të ofrojë formim teorik dhe përfitim e njohurive praktike, si në rrafshin artistik, ashtu dhe në fushën e mësuesisë. Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi janë në përputhje të plotë me objektivat e Departamentit të Arteve të Aplikuara, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe objektivave të Universitetit të Arteve.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë. Nr. 7 Statuti i UART neni 4, 7</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Arteve të Aplikuara, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë artistike kërkimore shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Në vitet e fundit 2019 – 2022 nga Programi i Studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi janë realizuar rreth 50 aktivitete të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozitë Studentore – Ambientet FAB, UART. - Work Shop – Qendra Harabel - Takim studentor në kuadër të praktikës mesimore – Shtypshkronja ALSA - Vizitë kulturore – Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë - Arkivi – Takim në Bibliotekën UART - Takim Virtual – Domosdoshmëria e mësimdhënies online Platforma TEAMS - Takim studentor – Temat studimore dhe doktorale - Ekspozitë Studentore – OPEN AIR – OutDoor Galeria FAB, UART. - Work Shop: Teknikat alternative PRINT MAKING – Laborator Grafika FAB - Work Shop: Vizatimi Digjital – forma të reja teknologjike – Laborator Multimedial FAB - Takim studentor: Print dhe Typografi – Praktika mësimore – Studio Grande Idea Office - Eskursion studentor – Tirana/Qyteti I Vitrinave, Analiza pamore për Dizajnin Grafik - Takim studentor – ArtOn Ekspozitë e Artit bashkëkohor, Qendra STEFANEL - Vizitë kulturore – ONUFRI REMADE, Konkursi ndërkombëtar I artit pamor, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë. - Vizitë kulturore – Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



YOU ACT LIKE MORTALS IN ALL THAT YOU FEAR AND
LIKE IMMORTALS IN ALL THAT YOU DESIRE –
Galeria70, Tiranë



- Vizitë kulturore – Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: MIRRORS SHOULD THINK LONGER BEFORE THEY REFLECT – Galeria e Artit, Shkodër
- Takim Studentor – Teksti Teorik në Arte, Dr. Flutura Haxhillari
- Ekspozitë Studentore – PORTOFOLIO GRAFIKA – Galeria FAB, UART
- Work Shop: Dizajni Grafik, lektor Harri Aleksi – Dcode packaging NR.1, Lektorium FAB
- Work Shop: Dizajni Grafik me Marsel Zara – Dcode packaging NR.2, Lektorium FAB
- Work Shop: 2 GULIVERËT me temë PERMOGRAFIA – Lektorium FAB & Qendra Harabel
- Takim studentor me kritikun Italian Giovanni Granzotto – Lektoriumi rrethor UART.
- Takim studentor me kuratorin amerikan Raino Isto – ZETA Qendra e Artit Bashkëkohor, Tiranë.
- Aplikimet studentore në pjesmarrjen e Bienales Ndërkombëtare të Grafikë, GAT – TIRANA.
- Takim Studentor me Street Artistin Grek SAME84 – Atelie Grafika, UART.
- Takim Studentor me artistin Ergys Krisiko në ekspozitën personale, COD, Tiranë.
- Vizitë studentore në ekspon graffiti SAME84 “Ne jemi Heronjtë tanë”, Muzeu Historik, Tiranë.
- Takim studentor – 8 Dhjetori / DITA E RINISË – Atelie Grafika, UART.
- Takim studentor me temë “DIPLOMA PAMORE” analiza studimore, Atelie Grafika, UART.
- Vizitë studentore në site arkeologjike për praktikën mësimore, Sarandë
- Vizitë kulturore - Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: KOMPLOTI I TIRANËS, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë.
- Work Shop – DARK CALIGRAPHY me lektor Harri Aleksi, Atelie Grafika, UART.
- Konkurs studentor për ilustrimin “TRUPI IM, E DREJTA IME”, RedCloud, Tiranë.
- Pjesëmarrje studentore në SPRING FESTIVAL, Open AIR – Sheshi Skënderbej, Tiranë.
- Takim kulturor për artisten Lumturi Blloshmi “KAFKA” – Qendra Harabel, Holli UART
- Vizitë studentore në ekspozitën e lektor Petraq Papa “ACTA URBANA”, Galeria FAB
- Takim kulturor dhe akademik në ekspozitën studentore “M.O.S.” të MULTIMEDIAS, Tiranë.
- Aksion Studentor në bashkëpunim me Postën Shqiptare “UKRAINA – Post Cards”
- Takim Studentor – Historiku i Filatelistë Shqiptare, Galeria e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


	<p>Postës Shqiptare, Tiranë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Work Shop – ATELIE GRAFIKA në bashkëpunim me Universitetin e New York-ut, UART. - Projekt Virtual Studentor “7 CHAMBERS” – ONLINE ART në bashkëpunim me BALPHIN GROUP, Tiranë - Projekt Grafik Studentor “RAPORTI VJETOR” – broshurë me ilustrime në bashkëpunim me BALPHIN GROUP, Tiranë. <p><i>Evidencë. Nr. 7 Statuti i UART neni 54, 116, 117, 118</i> <i>Evidencë. Nr. 11 .Rregullorja e njësisë kryesore</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 33, Projektet artistike të Prog të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi , nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete artistike. Kjo realizohet nëpërmjet punimit të diplomës, I cili është sa në rrafshin artistik, e po aq dhe teorik. Gjatë procesit të saj, studentët janë jo vetëm në kontakt të vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës, por dhe zhvillojnë kërkim në terren, intervista apo hulumtime të literaturës, raste studimore, të cilat ndikojnë pozitivisht në analizën teorike.</p> <p>Gjithashtu, stafi, departamenti i nxisin studentët të marrin pjesë në biseda, workshop-e, aktivitete artistike që kanë të bëjnë jo vetëm me përhapjen e ideve artistike por edhe me sfidat e tregut të punësimit dhe nxitjen e aftësive personale. Një vlerë e shtuar është dhe pjesëmarrja në mjaft ekspozita të përbashkëta, kolektive, individuale, dhe aktivitete të ndryshme që zhvillon fakulteti.</p> <p><i>Evidencë. Nr.7. Statuti i UART neni 123</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit neni 34 Punimi teorik i diplomës</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Universiteti i Arteve në përputhje me misionin e tij të mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës e të kërkimit artistiko - shkencor, përcakton në buxhetin e tij një fond për çdo njësi bazë sipas planifikimit të argumentuar.</p> <p>Institucioni i mbështet njësitë bazë të bazë të përftimeve që arrihen nga programet e projektet që zhvillohen në rrafsh kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e aktiviteteve artistike, të kërkimit artistik/shkencor dhe teknologjik, si dhe gjithashtu në bazë të organizimit të mobiliteteve të stafit dhe organizimit të ekspozitave që organizohen pranë Galerisë FAB, pjesë e insitucionit.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 7, 117, 139, 140, 141, 142 144</i> <i>Evidencë. Nr. 30. Model aplikimi të një projekti</i> <i>Evidencë. Nr.41. Të dhëna financiare nga Drejtoria ekonomike për tre vitet e fundit për fondet e planifikuara për Dep e Arteve të Aplikuara.</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=965&niveli=138</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Pavaresisht kësaj, GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme dhe konstante të njësisë bazë, duke e konkretizuar në mbështetjen financiare të stafit në hapjen e ekspozitave personale apo kolektive jashtë vendit, si dhe në mbështetjen e tyre në botimin e studimeve apo pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare sipas fushës përkatëse, aspekte këto, që do të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e ecurinë e programit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Veprimtaria artistike-kërkimore në Fakultetin e Arteve të Bukura realizohet, në të tre njësitë bazë/departamentet e tij përmes grupeve kërkimore që funksionojnë pranë këtyre njësiteve.</p> <p>Grupi mësimor është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron programi i studimit dhe harton përmbajtjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse në përputhje me kërkesat e kohës dhe të ekonomisë në vend. Gjithashtu ai është përgjegjës për përditësimin në vazhdim të tyre dhe për mbulimin e tyre me staf të kualifikuar të brendshëm ose të jashtëm. Çdo grup pune është përgjegjës për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e materialeve të nevojshme për procesin artistiko-kërkimor-shkencore, dhe për kualifikimin në vazhdimësi të tyre.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e Njesise Kryesore</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART.Neni 17 pika 1,2,3,4 neni 119 pika 4</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara, bashkëpunon ngushtësisht me departamentet e tjera të Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe me institucione arsimore, kulturore e shkencore të vendit ku disa nga punonjësit e këtyre institucioneve janë edhe pedagogë të ftuar në Departamentin e Arteve të Aplikuara për realizimin e projekteve artistike-kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 18. Marrëveshje bashkëpunimi te lidhura midis UART dhe institucioneve artistike, arsimore dhe kerkimore shkencore.</i> <i>Evidencë. Nr. 33. Materiale që tregojnë bashkëpunimin e Departamentit të Arteve të Aplikuara me departamente të tjera të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe jo vetëm</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Nëpërmjet projekteve artistike dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që UART që ka me institucione të tjera artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, mundëson organizimin e aktiviteteve artistike dhe shkencore, me qëllim rritjen profesionale të stafit, dhe arritjen e objektivave mësimore për studentët.</p> <p>Galeria FAB hapësira ku ky rezultat gjen vend ekspozimi është aktualisht galeria më dinamike në rang kombëtar me mbi 25 aktivitete në vit, dhe mbi 30 mijë vizitorë.</p> <p>Në rang programi vetëm në vitin 2021-2022 janë realizuar mbi 30 aktivitete mes ekspozitash, takimesh, ëorkshopesh, vizitash, aplikimesh etj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 8. VKM nr. 145 date 10.03.2021 Mbi satatusin e vecante te UART</i> <i>Evidencë. Nr. 31. Marrëveshje bashkëpunimi midis UART dhe institucioneve artistike apo mesimore dhe kërkimi shkencor</i> <i>Evidencë Nr. 32. Projekte/postera veprimtarish artistike</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=17&niveli=85</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë</p>	<p>Programi i studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, për tu përafuar sa më shumë me tregun e punës, programet e studimit të ciklit të dytë u</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	riorganizuan të gjitha në programe studimi në fushën e mësuesisë, ku studenti merr njohuri të thelluara në fushën e mësuesisë në specialitetin përkatës, konkretisht në artin e Grafikës, me synimin e formimit artistik por jo vetëm. Pjesë e kësaj reforme ishte edhe përfshirja e diplomave që lëshon Institucioni në profesionet e rregulluara (mësuesi), tashmë si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punën. <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART Neni 4</i> <i>Evidencë. Nr. 29. Programi i studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mesuesi”</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky kriter nuk aplikohet nga Institucioni.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master i Arteve në “ <i>Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i> ”, është ndërtuar mbi legjislacionin në fuqi dhe bën pjesë në profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Ky program studimi përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare.			
Konkluzione	<i>Gvj konstaston se programi i studimit ofron njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Pavarësisht kësaj, në bazë të vizitës në instucion, e të diskutimeve me studentët e këtij profili, u ngrit si diskutim krijimi I njësive kërkimore aplikative.</i> <i>Ngritja e një njësie të tillë do të ndihmonte akoma më shumë studentët dhe stafin në zhvillimin e këkrimeve dhe tekonologjive të reja. Ngritja e një laboratorit duhet të jetë një hapësirë për të krijuar, për të mentoruar dhe për inovacion; një mjedis unik mësuesor ku studentët mund të transformojnë idetë e tyre në prototip përmes eksperimentimit, inovacionit dhe dizajnit.</i> <i>Kjo njësi e kërkimit aplikativ mund të angazhohet dhe botimin e punës kërkimore të Universitetit në periodikë të caktuar që ndiqen nga departamenti përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	--	------------------------------	-----------------------------	-----------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit të Studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë shtjelluar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksion; - Seminari; - Projekti artistik është mund të jetë një vepër arti, një tekst teorik hulumtues i një koncepti, periudhe të historisë së artit, rrymë artistike ose një artisti, i cili mund të finalizohet me një ekspozitë/sfilatë ose me prezantim në fund semester/ viti. Ky projekt konsultohet nga studenti hap pas hapi me pedagogun duke filluar me dhënien e informacionit nga ky i fundit me anë të një leksioni apo trajnimi; - Kolokiumi është një formë e vlerësimit të njohurive të studentëve, e cila jepet me shkrim ose me gojë; - Puna individuale është vlerësimi i punës së bërë individualisht; - Detyrat praktike; <p>Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve</p> <p>Praktika që materializon dhe konkretizon, njohuritë e marra gjatë studimeve dhe njohjen e studentëve me tregun e punës; Teza/Diplomimi është detyrimi përfundimtar i studentit për të marrë një diplomë në fund të studimit të programit MA në <i>“Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”</i>. Gjithashtu një rol luajnë dhe ëorkshopet e leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, vendas dhe të huaj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 8. VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021,</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë. Nr. 28. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët individuale, grupet mësimore të studentëve që i përcaktohen në çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës. Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi udhëzohet dhe nxitet nga departamenti që të orientojë dhe informojë studentët mbi disa elementë përgjatë procesit mësimor siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pritshmëritë e tyre për programin dhe lëndën përkatëse; • njohuritë e tyre paraprake për çështjet më të rëndësishme që trajton lënda përkatëse; • mënyrën se si ata e vlerësojnë lidhjen e lëndës përkatëse me lëndë të tjera të programit mësimor; • Rëndësisë që ka lënda përkatëse për formimin e tyre si mësues

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423





E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al




	<p>në fushën e artit dhe të edukimit; Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 63, 68 Evidencë. Nr. 11. Rregullore e Fakultetit të Arteve të Bukura Evidencë. Nr. 12. Rregullore e ciklit të dytë të studimeve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies përmes rritjes së kapaciteteve të stafit akademik, institucioni, drejtuesi i departamentit dhe vetë anëtarët e departamentit nxisin pjesëmarrjen në trajnime, masterclass-e dhe aktivitete të tjera artistike të cilat kanë në fokus pikërisht cilësinë e mësimdhënies, përmes njohjes së metodave të reja të mësimdhënies, mënyrave të ndryshme të vlerësimit, etj. Mësimdhënia mbështetet në disa metoda të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mësimi frontal: transmetimi i koncepteve teroike dhe artistike</i> • <i>Demonstrimi: bazohet në parimin e imitimit dhe pedagogu ofron demonstrimin praktik se si përdoret një teknikë e caktuar</i> • <i>Qasja tutoriale: verifikimi i menjëhershëm i nxënësve së dijeve, me pyetje të synuara për studentët.</i> • <i>Diskutim: konsiston në një krahasim të punimeve, projekteve ndërmjet pedagogut dhe studentëve dhe ndërmjet studentëve. Kjo metodë përmes një procesi dialektik, pikërisht dialogut.</i> • <i>Rast studimor: si një strategji metodologjike e bazuar në reflektime në lidhje me një teknikë apo temë të caktuar.</i> • <i>Puna në grup: që optimizon bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë midis studentëve</i> • <i>Projekti: bazohet në një integrim teknikash, e mbi një temë të caktuar.</i> • <i>Brainstorming: nxit të mësuarin duke i dhënë pavarësi studentit, në lidhje me një temë specifike.</i> • <i>Puna laboratorike: Puna laboratorike favorizon të mësuarit praktik dhe dialogun, si dhe reflektimin mbi punën, duke favorizuar mundësitë që studentët të ndërtojnë në mënyrë aktive njohuritë e tyre. Mësimdhënia laboratorike inkurajon një qëndrim aktiv të studentëve ndaj njohurive të përfuara teorikisht. Ky mësim bazohet në nevojat e nxënësve individual; promovon të nxënësve në bashkëpunim; mundëson zhvillimin e aftësive.</i> <p>Gjithashtu, krahas kësaj metodologjie, fokusi i institucionit është në nxitjen dhe trajnimin e stafit dhe në integrimin e metodave bashkekohore, të cilat përkthehen në mësimdhënie dhe si praktika të mira që të integrohen në proceset mësimore. Programet Erasmus, Erasmus+ shërbejnë për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe të nxënësve. Rast konkret ka qënë vizita më e fundit e stafit të FAB, në Programin Erasmus Plus, në Sevilje të Spanjës.</p> <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni, 68 Evidencë. Nr. 11. Rregullore e Fakultetit të Arteve të Bukura Evidencë. Nr. 12. Rregullore e ciklit të dytë të studimeve Evidencë. Nr. 17. Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në projektet Erasmus, Erasmus+</p> <p>http://eë.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=686&niveli=72 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=785&niveli=126</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i</p>	<p>Personeli akademik që është i angazhuar në mësimdhënie në</p>

<p>angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>programin e studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, përveç titujve dhe gradave shkencore ka edhe eksperiencë dhe kualifikime të rëndësishme të krijuara nga takime ose aktivitete të rëndësishme artistike kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Këtë gjë e tregon dhe e dëshmon përzgjedhja e tyre sipas fushave, si dhe eksperiencë e tyre në fushat përkatëse. Këtë dëshmojnë gjithashtu dhe cv-të e stafitë pedagogjik që janë personalitete në fushat e tyre përkatëse, si dhe komunikimi që komisioni vlerësues pati me studentë, pati një feed-back pozitiv në lidhje me mësimdhënien, dhe marrëdhien dialoguese, mbështetëse dhe profesionale pedagog-student. Përgjatë vizitës në institucion, u konstatua dhe gjatë bisedave me studentët.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, në tri vitet e fundit, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Arteve të Aplikuara, ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë që mbulon 90% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Evidencë. Nr. 35. Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.</p> <p>Evidencë. Nr. 36. Të dhëna mbi titujt akademik dhe gradave shkencor të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe të dhëna të mbulimit të ngarkesës së programit në tre vitet e fundit nga një përqindje mbi 70% nga stafi akademik i brendshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Arteve, janë njësitë bazë. Njësia bazë, shqyrton raportimin e problematikave të hasura dhe ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog, duke bërë analizën mësimore, në funksion të mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Analiza e procesit mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik. Për të bërë këtë analizë, Departamenti i Arteve të Aplikuara mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritet mësimore.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", në përfundim të procesit mësimor shprehet për problematikën që ka hasur dhe mund të propozojë ndryshime në elementë të programit të lëndës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p> <p>Departamenti i Arteve të Aplikuara analizon të gjitha elementët e realizimit të procesit mësimor, si mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave, dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme.</p> <p>Përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies i shërben edhe mbikëqyrja e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe gjithë dokumentacionit të programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik asistohet nga personel ndihmës</p>

	<p>akademik dhe nga personel administrativ, të cilët angazhohen në ndihmë të procesit mësimor nëpërmjet elementëve të tillë si zhvillimi i punëve të laboratorit në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 15 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2019-2020).</i> <i>Evidencë. Nr. 12. 3 VSA Nr. 5 për Miratimin e raportit vjetor të UART për vitin akademik 2019-2020</i> <i>Evidencë. Nr. 38. Të dhëna nga pyetëtori i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Arteve, janë njësitë bazë. Njësitë bazë/Departamentet mbështeten në strukturat përkatëse si Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe Informimit të studentëve si dhe Sekretariatë mësimore pranë secilit Fakultet, duke koordinuar punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përftimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies.</p> <p>Organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike me studentë e pedagogë, bashkëveprimi midis tyre në këto veprimtari si dhe bashkëveprimi me departamente të tjera, është një nga format e veçanta dhe inovative të mësimdhënies në Departamentin e Arteve të Aplikuara.</p> <p>Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me formimin artistik të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, ëorkshope dhe konferenca artistike-kërkimore-shkencore. Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trainimi i stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit.</p> <p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, i cili dhe përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky process në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik. Departamenti harton sillabuset, kalendarët, caktimin e pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët aplikimin dhe vlerësimin, miraton institucionet e praktikave, etj. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit, ngritjen e komisioneve të posacme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me sektorët për përmirësimet të mëtejshme, etj. Departamentet hartojnë në mënyrë periodike raporte dhe vlerësime.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART, Neni nr.37</i> <i>Evidencë. Nr. 39. Të dhëna mbi mobilitetin e pedagogëve të Fakultetit të Arteve të Bukura</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas dokumentacionit të paraqitur, në tri vitet e fundit, Fakulteti i</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p><i>Arteve të Bukura, Departamenti i Arteve të Aplikuara, ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë që mbulon 90% të ngarkesës mësimore.</i></p> <p><i>Në bazë të raportit të paraqitur, të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesëshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.</i></p> <p><i>Pavarësisht kësaj, GVJ rekomandon shtimin e stafit akademik të jashtëm e të brendshëm, në mënyrë që stafi akademik të ketë mundësinë për tju dedikuar kërkimit shkencor dhe atij aplikativ.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në këtë program studimi, ashtu si edhe në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ofrohen në Universitetin e Arteve, për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Disa nga format organizimit të provimit në Fakultetin e Arteve të Bukura janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i lëndëve speciale 2. Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar; 3. Provim me shkrim e me gojë, ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë me gojë. 4. Provimi në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar. <p>Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim të semestrit.</p> <p>Të gjitha rregulloret janë të publikuara online në faqen e ëeb-it të universitetit të arteve.</p> <p><i>Evidencë. Nr.. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura</i> <i>Evidencë. Nr. 11. 1 VSA Nr. 37 datë 21.12.2021</i> <i>Evidencë. Nr.. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët</p>	<p>Programi i studimit është i publikuar në faqen zyrtare www.uart.edu.al Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër njihen me të gjithë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


<p>informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Një kopje elektronike e programit publikohet në faqen e ëebit, në të cilën shfaqen lëndët, semestrat, shpërndarja e krediteve si dhe lëndët me zgjedhje. Gjithashtu dhe stafik akademik, i ofron studentev informacione mbi programin, lëndët, detyrimet akademike, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin. Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim të semestrit. Në syllabusin e lëndës/modulit shprehen modalitetet e vlerësimit të saj.</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor</p> <p>Evidencë. Nr. 29. Programi i lëndës</p> <p>Evidencë. Nr. 28. Sillabus i lëndës</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar Rregullore së programit të studimit, Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, format kryesore të procesit mësimor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Format e mësimimit teorik e praktik: mësimet artistike, profesionale individuale dhe kolektive, leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, projektet artistike individuale dhe kolektive, konsultimet, etj. Format e kontrollit të dijeve: bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike (Ekspozita tematike), etj. <p>Kontrolli i dijes bëhet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Provimit me shkrim. Provimit me gojë. Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve. Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt. Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit. Provimi në grup dhe individual. <p>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor</p> <p>Evidencë. Nr. 29 . Programi i lëndës</p> <p>Evidencë. Nr. 28. Sillabus i lëndës</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.3
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i studentit kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe gjatë gjithë vijimësisë së ndjekjes së programit të studimit. Në programin e lëndës është përcaktuar qartë edhe mënyra e vlerësimit, pesha e secilit komponent dhe shpërndarjen e pikëve. Format e testimit të studentëve është e shprehur si më poshtë kanë këtë peshë: Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10% Puna e pavarur krijuese: 20% Detyrat e kursit: 20% Projektet e kursit: 20% Provimi përfundimtar: 30% Provimet në Fakultetin e Arteve të Bukura, zhvillohen brenda periudhave të përcaktuara në strukturën mësimore të vitit Akademik. Provimet, zhvillohen në tre sezona. <i>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i> <i>Evidenca. 28. Tip sylabusi i lëndës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e organizimit të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, zbatohet sistemi i provime të cilat zhvillohen në auditor. Gjatë kohës së pandemisë institucioni mori masa për organizimin e mësimit dhe kontrolleve online, nëpërmjet sistemit Microsoft Teams, zbatuar dhe të administruar nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Studentët i mbrojtën provimet online, me mënyra alternative, individualish apo me grupe të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=963&niveli=68</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga titullari i lëndës/modulit si dhe nga një pedagog tjetër përgjegjës. Praktika profesionale dhe diplomimi, që janë dhe detyrimet përmbyllëse, realizohen nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme, duke ndjekur përcaktimet në Rregulloren e programit të studimit MA në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi. Universiteti i Arteve, në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë Master, por edhe në Rregulloren e programit të studimit Mastër i Arteve në <i>“Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”</i>, ka të përcaktuar qartësisht sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • sistemin e vlerësimit; </p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<ul style="list-style-type: none"> • format e kontrollit; • sezonet e provimeve; • provimi dhe kontrolli i dijes; • dokumenti i vlerësimit të studentëve; • Kushtet e kalimit në vitin pasardhës si dhe përmirësimi i notës. <p>Në syllabus paraqiten format e vlerësimit të lëndës, mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar e paraqitur në orë dhe në kredite. Syllabusi i bëhet të ditur studentit që në fillim të semestrit. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, që përkthehen në notë. Tezat e provimit për lëndët teorike, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/ët i/e lëndës dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p> <p>Evidencë. Nr. 12. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master.</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e ciklit të dytë Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”</p> <p>Evidencë. Nr. 29. Programi i lëndëve për programin e studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Aftësimi teorik dhe praktik i studentëve kontrollohet përmes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e modulit dhe vlerësimit përfundimtar në provimet e çdo fund-viti, në provimin e praktikës profesionale si dhe në mbrojtjen e diplomave apo provimit të formimit. Konsultat e evazhdueshme janë një metodologji pune e këtij program, për vetë nyrën e metodikën sesi lëndët zhvillohen.</p> <p>Në përfundim të çdo simestri, çdo pedagog kryen analizën e punës atelieit, analizë që më pas bëhet në rang departamenti dhe më pas në rang fakulteti.</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në lidhje me kryerjen e provimeve, institucioni I ka të përcaktuara në rregullore të gjithë hapat e procedurat konkrete të zhvillimit të provimeve. Në vëzhgimin e ecurisë së provimit, anagazhohen staf i paracaktuar, në mënyrë që provimet të zhvillohen në mënyrë sa më korrekte.</p> <p>Verifikimi i cilësisë së punimeve shkencore është realizuar përmes platformës anti-plagjiaturë të vënë në dispozicion nga RASH dhe të administruar nga Sektori i TI sipas udhëzimeve të Këshillit të Etikës së Institucionit.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=98&niveli=104</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>

<p>bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet hidhen edhe në Sistemin elektronik, ku studenti i pasqyrohen të gjitha vlerësimet sipas komponentëve përkatës.</p> <p>Në UART nga 2021, përdoret sistemi PITAGORA për menaxhimin e studimeve dhe të kurrikulës në shërbim të marrëdhënies Pedagog - Student – Institucion. Ky sistem është mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe administrohet nga Sektori i TI në bashkëpunim me RASH, si edhe në koordinim me Sekretaritet Mësimore në Fakultete dhe strukturat përkatëse në Rektorat. Ky sistem që përmban të dhënat që hidhen nga Sekretaritet Mësimore në Fakultete kryen funksione administrative, administrim të didaktikës: ofertës akademike/ karrierës së studentit/ provimeve dhe notave, administrim të studentëve hyrës dhe dalës, shërbime të tjera, etj.</p> <p>Sistemi përdoret nga pedagogët për pasqyrimin e rezultateve dhe përpilimin e procesverbaleve, përdoret nga studentët për informimin e tyre lidhur me aktivitetin akademik në Universitet (kalendarët, provimet, notat, njoftimet, etj.), si dhe përdoret nga personeli administrativ në Rektorat për përpunim të dhënash statistikore.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=585&niveli=67</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit.</p> <p>Evidencë Nr. 46. Manuali TI</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tre deri në pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur. Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i Departamentit të Arteve të Aplikuara, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar. Ankesa depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanat, e cila shqyrtohet nga Dekani. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda 3 (tre) ditëve. Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të jap përsëri provimin, me të njëjtin</p>

përmbyllëse.	<p>projekti, dhe finalizohet me një studim shkencor dhe kritik.</p> <p><i>Evidencë. Nr.15. Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Një ndër elementët e rëndësishëm dhe specifik të procesit mësimor në këtë program studimi është puna në grupe të ndryshme e studentëve të cilët bashkëveprojnë me njëri tjetrin jo vetëm me studentët e këtij programi por edhe me studentët e programeve apo departamenteve të tjera, brenda institucionit apo dhe në institucione të tjera artistike kulturore.</p> <p>Cilësia akademike garantohet dhe përmes angazhimit, të stafit që me gradat përkatëse shkencore por edhe me personalitete apo ekspertë në fusha të caktuara të arteve pamore. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin trajtimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, të cilat stafi akademik i përfton dhe gjatë shkëmbimit të ideve e eksperiencave të ndryshme, brenda dhe jashtë institucionit. Kjo vjen natyrshëm, dhe për vetë natyrën metodologjike që kanë fushat e artit në përgjithësi, ku lind, dhe është domosdoshmëri, zhvillimi i performancës individuale, dhe bashkëpunimi në grup. Kjo gjë bazohet në planin strategjik të Departamentit të Arteve të Aplikuara, i cili synon, të mbështesë si studentët në avancimin e njohurive të tyre, gjithashtu dhe në mbështetjen e stafit akademik, ku puna, dhe pasurimi i aktiviteteve të tyre, rrjedhimisht reflektohet më pas dhe në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara Nenet 39, 40</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 40 Të dhëna mbi mobilitetin e studentëve për programin e studimit aster i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në Fakultetin e Arteve të Bukura organizon në mënyrë të vazhdueshme Ekspozita, të stafit pedagogjik, studentëve të njërit apo shumë programeve studimore, brenda dhe jashtë institucionit, ëorkshope, leksione të hapura me të ftuar nga brenda apo jashtë institucionit, në bashkëpunim me personalitete dhe institucione, vendas apo të huaj. Në Fakultetin e Arteve të Bukura janë realizuar mesatarisht çdo vit 25 - 30 aktiviteteve artistike, mes ekspozitash, ëorkshope e leksione të hapura, ku Galeria FAB, mbetet një nga hapësirat më aktive në kryeqytet.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 32. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga pedagogë dhe studentë të FAB</i></p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=17&niveli=85</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=129&niveli=97</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuarra</p>	<p>Për vetë natyrën e fakultetit të Arteve të Bukura, organizohen aktivitete me punime të studentëve e cila drejtohet nga pedagogët e Programit, apo dhe në raste të veçanta këto aktivitete realizohen nga vetë studentët</p>

<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>e këtij Fakulteti, ose së bashku me pedagogët e lëndës. Gjithashtu një rol në mbështetjen e studentëve, luanjnë dhe Këshillat studentorë. Këshillat Studentore të Universitetit të Arteve kanë si objektiv të tyre të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve. Këshillat Studentore shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Institucionit, si për planet ashtu edhe për programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=136&niveli=79 Evidencë. Nr. 32. Fletpalosje nga aktivitetet me studentët dhe Pedagogët e FAB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se në lidhje me mbështetjen financiare të studimeve të përparuara, institucioni i mbështet studentët në mobilitetet që ata mund të zhvillojnë në shkolla të tjera europiane, duke përfshirë njohuri të reja.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedurat e diplomimit si dhe kriteret e hyrjes në diplomim janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë Master, si dhe në Rregulloren e programit të studimit, ku paraqiten:</p> <ul style="list-style-type: none"> • modalitetet e diplomimit • punimi i diplomës • përgatitja e diplomës • organizimi i mbrojtjes së diplomës • vlerësimi i punimit • lëshimi i diplomës • suplementi i diplomës <p>Evidencë. Nr. 12. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master e UART, Kreu V; neni 18, 22, Kreu VIII. Evidencë, Nr. 9. Diploma, Suplementi i Diplomës dhe aneksi i diplomës http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=134&niveli=77</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, si strukturë e informimit dhe të këshillimit të studentëve përveç sekretarive mësimore të fakulteteve është edhe zyra e Sektorit Mësimor dhe Informimit të Studentëve. Informimi i studentëve kryhet nëpërmjet formave të ndryshme, si për shembull këshillimit dhe informimin online nëpërmjet faqes zyrtare të UART, siç është Faqja elektronike e Fakultetit të Arteve të Bukura. Personeli akademik informon studentët nëpërmjet kontakteve të herëpashershme dhe të vazhdueshme me ta duke i udhëzuar me detyrimet përmbyllëse</p>

	<p>dhe kryesisht me punimin e diplomës.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, dy muaj pas fillimit të vitit të dytë akademik, studentëve u jepet informacioni mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=9&niveli=83 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=5&niveli=9 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=135&niveli=78</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Përgatitja dhe paraqitja e punimit/programit të diplomës në Fakultetin e Arteve të Bukura ndjek normat e përcaktuara dhe hapat proceduriale të përcaktuara dhe në "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura". Punimi i diplomës përmban një sërë detyrimesh e kërkesash, dhe bazohet në testimin e njohuritë praktike e teroike që studenti ka përfutur gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 47</i> <i>Evidencë. Nr. 12.1. dhe 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara", Fakulteti i Arteve të Bukura</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temës së diplomës, në bashkëpunim me studentin, përcakton programin e diplomës, duke vendosur edhe afatet e përafërta e periodike për çdo rubrikë të programit të diplomës. I gjithë semestri i dytë i vitit të dytë të studimit Master, i kushtohet përgatitjes së diplomës nga studentit. Përgatitja e diplomës konsiston në takime sipas orarit të mësimit të përcaktuar që në fillim të vitit akademik. Takimet për përgatitjen e mbrojtjes së diplomës kryhen në mënyrë individuale (ose në grup), dhe çdo student duhet të respektojë afatet për të bërë të mundur realizimin me sukses të programit për mbrojtjen e diplomës në sezonin e caktuar të tij.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 48</i> <i>Evidencë. Nr. 12.1. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara".</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni i asiston dhe i mbështet studentët për kryerjen e projekteve artistike duke respektuar maksimalisht profilin e tyre individual, si dhe për zhvillimin e metodave, përpunimin e të dhënave, të përfutur në terren, si dhe analizimin e tyre, për interpretimin sa më artistik e po ashtu teorik. Projektet artistike mbështeten nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, në drejtim të mbështetjes infrastrukurore dhe pjesës së mentorimit e zhvillimit të tyre.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 33. Projekte artistike studentësh mbështetur nga Departamenti i Arteve të Aplikuara.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet</p>

	<p>proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin shënohet nota përfundimtare.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 50</i> <i>Evidencë. Nr. 12. 1. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara".</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e saj. Institucioni ndjek procedurat e duhura për diplomën e studentit sipas hapave dhe rregullave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe bazuar tek aktet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 51</i> <i>Evidencë. Nr. 12. 1. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Arteve të Aplikuara".</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Informacioni i veprimtarisë akademike në UART përpunohet në hardcopy dhe në formë elektronike dhe ruhet në arkivin e institucionit. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit. Në lidhje me procedurat që kryhen për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, institucioni i ka të përcaktuara në dokumenta të veçanta.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm, aspekte të cilat janë paraqitur në rreulloren e programit, si dhe të fakultetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Ky program studimi është program studimi i ciklit të dytë Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave</p>	<p>Ky program studimi është program studimi i ciklit të dytë Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.									
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky program studimi është program studimi i ciklit të dytë Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi								
Konkluzione									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbylur</th> <th>Përmbylur pjesërisht</th> <th>Përmbylur kryesisht</th> <th>Përmbylur plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbylur	Përmbylur pjesërisht	Përmbylur kryesisht	Përmbylur plotësisht				
Përmbylur	Përmbylur pjesërisht	Përmbylur kryesisht	Përmbylur plotësisht						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbylur</th> <th>Përmbylur pjesërisht</th> <th>Përmbylur kryesisht</th> <th>Përmbylur plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbylur	Përmbylur pjesërisht	Përmbylur kryesisht	Përmbylur plotësisht				X
Përmbylur	Përmbylur pjesërisht	Përmbylur kryesisht	Përmbylur plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e	Në përgjithësi gjatë hulumtimit të të dhënave të DVV, përgjatë vizitës në institucion por edhe bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, GVJ konstaton se stafi i ngarkuar në realizimi e këtij programi studimi në shumicën dërmuese përmbush kërkesat ligjore por edhe kërkesat akademike në ofrimin e lëndëve që mbulojnë. Në vështrimin e CV të stafit akademik, pedagogët e angazhuar në mësimdhënien e lëndëve bazë kanë një karrierë artistike të arrirë. Si institucion specifik i artit, me një fjalë si institucioni i vetëm arsimor publik në fushën e artit skenik, pjesa dërmuese e personelit akademik me kohë të plotë dhe një pjesë e mirë e atyre me kontratë janë Alumni të dalë nga po auditorët e Departamenti i Arteve të Aplikuara në Fakultetin e Arteve të Bukura. Të njëjtën gjë konstatojmë edhe për personelin ndihmës akademik të Departamentit të Arteve të Aplikuara në Fakultetin e Arteve të Bukura. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e stafit akademik efektiv

<p>moduleve të tij.</p>	<p>dhe me kontratë / me kohë të pjeshme për këtë program studimi.</p> <p>Personeli akademik Efektiv (PAE)¹</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik/</th> <th>2019 - 2020</th> <th>2020 - -2021</th> <th>2021 - 2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Tituli grada</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof asc dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof asc</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>As Lektor</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik me kontratë/ I jashtëm (PAK)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik/</th> <th>2019 - 2020</th> <th>2020 - -2021</th> <th>2021 - 2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Tituli grada</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>As Lektor</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Docent</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik/	2019 - 2020	2020 - -2021	2021 - 2022	Tituli grada				Prof asc dr	1	1	1	Prof asc	1	1	1	Prof	1	1	1	Dr	1	1	1	As Lektor	5	5	5	Viti akademik/	2019 - 2020	2020 - -2021	2021 - 2022	Tituli grada				As Lektor	3	3	3	Docent	0	0	0	Dr	0	0	0
Viti akademik/	2019 - 2020	2020 - -2021	2021 - 2022																																														
Tituli grada																																																	
Prof asc dr	1	1	1																																														
Prof asc	1	1	1																																														
Prof	1	1	1																																														
Dr	1	1	1																																														
As Lektor	5	5	5																																														
Viti akademik/	2019 - 2020	2020 - -2021	2021 - 2022																																														
Tituli grada																																																	
As Lektor	3	3	3																																														
Docent	0	0	0																																														
Dr	0	0	0																																														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësuar të dhënat e paraqitura në fund të raportit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit objekt vlerësimi nga GVJ, Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, ngarkesa e personeli akademik na del se më e ulta 60 orë mësimore dhe më e larta 120 orë mësimore. Gjithashtu ia vlen të theksohet që në të dhënat tabelore janë paraqitur edhe ngarkesa e personelit akademik të brendshëm në Departamente të tjera të FAB por edhe në Departamente të tjera të fakulteteve të UART të cilat japin mësim edhe në këtë program studimi. Ngarkesë e këtij stafi është dhënë në total së bashku me orët në programet e tjera të studimit.</p> <p>Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit është në përputhje me VKM Nr 29, datë 10.09.2008, i ndryshuar.</p>																																																
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në DVV por edhe gjatë takimeve që realizoi në Institucion si me drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit por poashtu edhe me stafin akademik, konstaton se një nga pikat e forta të këtij programi studimi, por edhe të gjitha programeve që ofrohen në fakultetin e artit aplikativ, është stabiliteti i stafit akademik dhe qëndrueshmëria tij. Jo vetëm për tre vitet akademike që shtrihet vlerësimi i këtij programi por edhe më herët, stafi akademik nuk ka patur ndonjë lëvizje.</p> <p>Në kuadër të vizitës në Burimet njerëzore, GVJ ka shfletuar kontratat e punës për një personel akademik efektiv dhe për një personel akademik me kontratë apo me kohë të pjesëshme. Kontratat ishin të rregullta përgjithësisht.</p> <p>GVJ iu deklarua se UART paguan rregullisht si sigurimet shëndetësore ashtu edhe sigurimet shoqërore.</p>																																																
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me</p>	<p>Gjithashtu gjatë vizitës në interesimin si GVJ se si procedohet me kërkesën për të rekrutuar personel akademik na u tha se kërkesa lind në Departament e si rrjedhojë procedura vijon si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i bën gati kriteret e punësimit për personelin akademik të nevojshëm që të mbulojë lëndën e caktuar. - Zakonshëm kriteret publikohen në webfaqe të UART-it, ku kriteret 																																																

¹ “UART”, Fakulteti i Arteve të Bukura, DSK, “Rregullorja e Programit MA Pikturë Grafike dhe Mësuesi”, ASCAL, Evidenca Nr.2.5.4. Parë në Nëntor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>e punësimit duhet të jenë shumë të qarta si specifika të lëndës e për këto kriteret dhe mbarëvajtjen kujdesi bie direct te Përgjegjësi i po atij Departamenti.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kur pranohet kërkesa e bazuar në kriteret e mësipërme atëherë roli i Rektorit të UART-it është që të formulojë një dokument kryesisht informues si finale e këtij procesi pranues. - Në fund i njëjti Dokument që bartë firmën e rektorit shpallet publikisht në median e shkruar apo elektronike, si dhe në vende të dukshme. - Fill pas dërgesës së dokumentacionit te Burimet Njerëzore në Rektorat, Dekani inicon krijimin e komisionit ad hoc për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në vijim. - Detyra e komisionit është që vë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve bazuar në rezultatet e vlerësimit final. - Menjëherë pas vlerësimit Kandidaturat e renditura sipas pikëve të fituara nga kriteret e përzgjedhjes i dërgohen Rektorit për procedurë të mëtejshme. - Bazuar në renditjen e tyre Rektori shpall fituesin - Dhe në fund Rektorit i takon vendimi për miratimin përfundimtar që lidhet me kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur gjatë këtij procesi . <p><i>(Evidencë 5.7... Dosja e praktikës së punësimit në FAB/UART)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Struktura administrative dhe ndihmës akademike në DAA përbëhet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sekretaria e Fakultetit të Arteve të Bukura -Kryesekretarja -Sekretar/e/i (Specialisti/e) për kurrikulën dhe informimin e studentëve -Kryetari i Degës së FAB -Lborantët (1 laborant për Prog. Stud.) -Punonjësit e shërbimit (2) <p>Përgjatë vizitës GVJ-së iu komunikua se personeli ndihmës akademik në këtë rast dhe një pjesë e personelit administrativ, janë të angazhuar që të ndihmojnë procesin mësimor përmes elementeve të tillë si zhvillimi i punëve laboratorike në përputhje me programin e studimit, si dhe ndër të tjera ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, poashtu mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj. Synimi i tutjeshëm është që të angazhohet një personel ndihmës akademik me kualifikim të lartë në fushën gjegjëse. Një gjë tjetër që na u tha si GVJ është se Stafi administrativ gjithashtu është trajnuar vazhdimisht për të qenë në koherencë me kërkesat e kohës.</p> <p><i>(Evidenca 5.8... Lista e stafit ndihmës akademik FAB)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit</p>	<p>I tërë dokumentacioni si dhe të gjitha të dhënat e personelit akademik që kanë lidhje me kualifikimin personal të tyre, përfshirë këtu aktivitetin artistik e atë shkencor mbahen në dosjen personale të tyre të cilat administrohen nga Burimet Njerëzore. GVJ-ja gjithashtu u informua se stafit akademik në vijimësi I udhëzohet që të përditësojë vazhdimisht CV-të e tyre, ngase aktiviteti i tyre sidomos ai artistik është</p>

<p>akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>gjithmonë në rritje. Edhe në aktivitetet vetanake artistike por kjo gjithashtu mbështetet në aktivitetet e larmishme që organizon vet Fakulteti i Arteve të Bukura por poashtu edhe në bashkëpunim me Fakultete e tjera brenda UART. Sidomos vlen të ceket ajo që na u komunikua si GVJ një bashkëpunim që cilësohej i fundit ishte ai me Fakultetin e Muzikës me rastin 60 vjetorit të krijimit ku kishte marrë pjesë stafi akademik nga Departamenti Arteve të Aplikuara.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë evidentimit të një dosje së DVV, por edhe gjatë komunikimeve në Institucion sidomos me stafin akademik dhe me Dekanatin e FAB, GVJ-së iu komunikua se Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", duhet të realizojnë praktikën mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë. Saktësisht Departamenti i Arteve të Aplikuara /FAB nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me institucionin pranë të cilit do të zhvillohet praktika ose me institucionin qëndror. Por në rastet e nënshkrimit të marrëveshjes me institucionin qëndror, veç të tjerash, parashikohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shkolla/t pranë të cilave do të mbarohet praktika mësimore; -Si dhe numri i studentëve për çdo shkollë. <p>Ndërsa në vijimësi Departamenti i Arteve të Aplikuara/FAB, përcakton një ose disa pedagogë, në varësi të numrit të studentëve për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës.</p> <p><i>(Evidencë Nr. 22. 3.... Dosja e Praktikës Profesionale)</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Zakonshëm për realizimin e praktikave pranë institucioneve të tjera, në këtë fazë DAA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje e ka të përfshirë angazhimin e një pedagogu, përfaqësues të FAB, në monitorimin e praktikës dhe një përfaqësues të institucionit pritës. Teksa përfaqësuesi i institucionit pritës monitoron dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Krejt në fund të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të monitoruar gjatë kësaj faze. Në kuadër të realizimit të praktikës mësimore parashikohet si pjesë e planeve mësimore si dhe përmban një numër kreditesh të caktuara, studentët e kanë të detyrueshme përfundimin e saj.</p> <p><i>(Evidencës Nr. 22. 3. Dosja e Praktikës Profesionale)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se bashkëpunimet e kësaj natyre janë realitet dhe studentët gjejnë veten në institucione të tjera gjatë praktikës që e kanë si një parakusht që duhet kryer gjatë studimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43473

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Universiteti i Arteve si një institucion arsimor i lartë me specifikë të veçantë, ofron ambient infrastrukturor që mundësojnë mësimdhënie më inovative me staf administrativ ndihmes-mësimor, në funksion dhe në shërbim të procesit mësimor. Duke e konsideruar një sipërfaqe 2475 m² vetëm për FAB nga ajo e përgjithshmja e UA-së që përmban në total 13548.

Kjo infrastrukture është përshtatur që të përmbushë nevojat e veprimtarive kërkimore shkencore, veprimtarisë artistike përfshirë nevojave të mësimdhënies.

Duke pas parasysh natyrën specifike që ka në vete vet Programi I Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, sin ë anën organizative të mësimit në FAB, hapësirat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dmth mundësojnë që të pranishëm të jenë një numër më i konsiderueshëm i individëve deri 200. Përgjithësisht FAB si institucion ka mjaftueshëm hapësira për t'iu përgjigjur ngarkesës mësimore. Një vend të veçantë zë këtu poashtu se duhet cekur se Galeria FAB, me 4 hapësira me një sipërfaqe 240 m². E rikonceptuar me hyrjen nga jashtë, për të pasur kontakt direkt me publikun, Galeria konsiderohet hapësira më atraktive në skenën e artit bashkëkohore me rreth 30 aktivitete artistike në vit, dhe 30 mijë vizitorë një numër i konsiderueshëm. GVJ-së iu komunikua se si me një anë të një politike të re menaxheriale ajo pjesë është konvertuar në një hapësirë ku dialogohet dhe ballafaqohet puna e studentëve dhe e publikut më të gjerë.

Institucioni për të mbështetur më seriozisht mësimdhënien për Fakultetin e Artit Aplikativ, pjesë e të cilit është edhe Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, Departament i cili ofron programin e studimit objekt vlerësimi, MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", ofrohen ambiente në ndërtesat e UART-it, që hapësira në total është 13548 m² ndërsa veçanërisht hapësira e FAB-it është 2475 m². Përgjatë vizitës së GVJ-së në këtë institucion na u prezantuan një ambient që është më klasor për ushtrime dhe një hapësirë tjetër më reprezentative që është Galeria. Në dosjen e DVV-së, theksohet se FAB-i gjendet në pjesën D të UART-it, në një ndërtesë të vitit 1972. Në total sipërfaqja e objektit është 1066 m², prej të cilave nga 534 m² janë sipërfaqe janë të parapara për klasa mësimore; 138 m² janë sipërfaqe në funksion të zyrave; 47 m² janë sipërfaqe të ambienteve ndihmëse për mësim dhe 347 m janë Sipërfaqe ambiente ku është menduar të bëhet shërbim dhe komunikim përgjithësisht.

Evidenca 22.2 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta.

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të

Pjesët siç janë laboratorët apo ngjashëm ku realizohet pjesa mësimore në Programin e Studimit Masteri i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi janë të pajisura me aparaturat e teknologjisë së informacionit që janë të domosdoshme për zhvillimin e mësimit si process. Duke pasur parasysh specifikën e lëndës Njësia bazë në reklacion me strukturën tjetër si zv.dekanin dhe sekretarinë mësimore të FAB-it vendos për përdorimin e hapësirave që kanë mjetet e teknologjisë së informacionit sepse jo në të gjitha lëndët janë të domosdoshme këto mjete.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

mësimdhënies-mësimnxënies:	(Shih Evidenca 22.2. 1 Lista e pajisjeve në shërbim të Njësoa Bazë për vitet 2022-2025)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateli të apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Në vizitën e realizuar të GVJ-së në institucion si dhe mbështetur në RVB deklaroi se, studiot dhe laboratorët e FAB/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të Programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, aparatura të cilat përmbushin kriteret për formimin teorik dhe praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit.</p> <p>Sipas specifikës së programit të studimit pajisjet dhe aparaturat që përdoren në Departamentin e Arteve të Aplikuara/FAB në shërbim të realizimit të programeve speciale në pjesën më të madhe nuk janë pajisje dhe aparatura konvencionale siç përdoren rëndom në laboratorë formimi në IAL të tjera. Megjithatë studentëve u ofrohen mundësitë të njihen, prekin e përdorin, fjalën e fundit të teknologjisë në specifikën përkatëse.</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>GVJ ju komunikua gjithashtu gjatë vizitës edhe në institucion se Departamenti Arteve të Aplikuara zotëron në ambientet e tij, përfshirë laboratorë të pajisur me kompjuterë dhe programe profesionale. Specifika e programit nuk e ka në qendër përdorimin e këtyre laboratorëve të teknologjisë andaj pasi vetë studio dhe klasat mësimore janë laboratorë të mirëfilltë në lëndët e Arteve Aplikative; Softueret Grafikë me të cilat janë të pajisura këto laboratore gjejmësiht programet profesionale janë të natyrës që mund të përditësohen me të rejtat e fundit për çka edhe janë shumë të rëndësishme për studentët.</p> <p>Në laborator si GVJ-së gjetëm pajisjet me këto performansa të cilat përdoren nga studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -2 janë të llojit MAC Hight Sierra (version 10.13.3) iMac Pro (27-inch, 2017) -5 janë të llojit MAC Mojave (version 10.14.6) iMac (Retina 4K, 21.5-inch, 2017) <p>Studentët shërbehen me këta kompjuterë të cilët kanë të instaluar programet e paketës së Adobes, Microsoft Office.</p> <p>Poa shtu laboratori multimedial që praktikohet edhe për piktura, pra vizatim dixhital, ka pajisur Wacom Desktop Center, ku secili kompjuter poashtu është i pajisur me Wacom, Model DTH 3220.</p> <p>Përgjatë vizitës në këtë laborator vërtetojmë si GVJ se disponon skanër 3D për printim në 3D të objekteve të ndryshme që krijojnë studentët.</p> <p>Kësaj hapësire e përdorshme i shtohet normalisht pjesa e Bibliotekës Shkencore të UART-it e cila në klasë përmban 20 kompjuterë personal poashtu me programe profesionale</p>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në	<p>Përgjatë vizitës, GVJ-së iu tha se praktikantët e zhvilluar në programet e studimit në Artet Aplikative janë praktika profesionale artistike dhe praktika mësimore.</p> <p>Pra, praktikantët profesionale artistike, në përputhje me specifikën e programit të studimit, materializohet në përfundimin e përvojave kryesisht artistike sipas programit për çdo vit studimi. Në esencë këto praktika zhvillohen në ambientet e UART-it me të gjithë infrastrukturën e nevojshme ose në institucionet partnere të UART-it. Vlen të thuhet se këto praktika zhvillohen vetëm përgjatë studimeve të ciklit të parë Bachelor.</p> <p>Në kuadër të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë</p>

rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Grafikë dhe Mësuesi zhvillohen praktika mësimore, teori e praktikë. Praktikë mësimore zhvillohen në marrëveshje me DAR dhe pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Në lidhje me këtë DAA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. <i>(Shih Evidencë 3.3.... Dosja e Praktikës Profesionale)</i>		
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën për realizimin e procesit mësimdhënies të programit të studimit. Pjesa teknologjike është domosdoshmëri që UART-i e ofron. <i>Përgjithësisht FAB si institucion ka mjaftueshëm hapësira për t'iu përgjigjur ngarkesës mësimore. Pavarësisht kësaj, rekomandohet shtimi i hapësirave apo ngritja e një godine të re institucionale, pasi një pjesë e tyre janë tashmë të amortizuara. Duke patur parasysh dhe trendin në rritje të regjistrimit të studenteve në këto fushë, shtimi i hapësirave vjen si një nevojë. Rikualifikimi strukturor i godinës deri më tani është ngritur dhe rinovuar vazhdimisht me kontributin e vetë institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		x	


Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në përgjithësi GVJ deklaroi se literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde. Biblioteka siç na u prezantua gjatë vizitës dispononte literaturë bazë dhe ndihmëse siç parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Pra, rrjedhimisht studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara: <ul style="list-style-type: none"> - fizikisht (hard copy) në Bibliotekën e UART-it; Fondi referues -enciklopedi, diksionere, tituj 150 + 100 fjalor Letersia shqipe -3040 tituj Letersia e huaj -2646 tituj Drama, perkthime teorike, ne shaptilograf, fotokopje, printime - 1000 tituj Estetika, , filozofi, psikologji, sociologji -200 tituj Histori arti -411 tituj Teori arti -68 tituj Piktura -1536 tituj Vizatirn-309 tituj Skulpture -687 tituj Fashion , tekstil -94 tituj Grafika -300 tituj Fotografia -388 tituj

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423




web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>Etnografia -77 tituj Serialet -1455 tituj kopmplete</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara (nëse e parashikon specifika e lëndës); - nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar. <p>Gjatë vizitës në Bibliotekën e UART-it, GVJ-së iu qartësua në lidhje me Literaturën në funksion të këtij programi studimi. 750 tituj monografi shkencore të fushave të ndryshme mbi muzikën, letërsinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe. Katalogun online e kërkoni në adresën uart.edu.al/katalog_biblio. Poashtu disa monografi shkencore shqipe mbi artin para viteve 90-ta gjenden në arki.uart.edu.al 33 tituj – periodik shqiptar përfshirë gazeta dhe revista mbi kulturën, artin dhe letërsinë 35 tituj – periodik shqiptarë politiko – social – shoqëror – kulturor, gjenden artikuj të publikuar mbi artet e muzikën. Periodiku retrospektive - kerkimi behet ne katalogun online dhe sherbehet ne fondin e mbyllur per tu studiuar ne sallen e leximit me fonde te hapura nga ora 8:00 - 19:00.</p> <p><i>(Shih evidencë 3.2...Kurrikula e Programit të Studimit Master)</i> <i>(Shih evidenca 5.12....Lisat e literaturës DAA në Bibliotekën e UART)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia që është përgjegjëse siç iu tha GVJ-së se Departamenti i FAB, në fillim të çdo viti akademik, njofton pedagogët e lëndëve për afatet e rishikimit të programeve të lëndëve (syllabuset). E së bashku me rishikimin e programit të lëndës, nëse ka, pedagogu ka mundësinë e rishikimit dhe përditësimit edhe të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse. Departamenti i FAB-it, nisur nga propozimet e pedagogëve të lëndëve dhe hulumtimet e kryera veçmas parashikon përditësimin e literaturës dhe pasurimin me materiale (libra, artikuj etj) të tjera.</p> <p>Lista e literaturës së detyrueshme është e përcaktuar qartë në Syllabuset e lëndës. Të kushtëzuar nga mungesa e një tregu të mirëfilltë për botime të mirëfillta artistike/pedagogjike në gjuhën shqipe, literatura është kushtëzuar të jetë në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Departamenti i FAB-it ka mundur të sjellë risi në sipërmarrjen e pedagogëve të saj për t’u bërë pjesë e përkthimeve të kolanave të klasikëve të mendimit teorik dhe artistik.</p> <p><i>(Shih Evidencë 5.12 Lista e literaturës FAB-it në Bibliotekën e UART)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të studentëve që ndjekin këtë program studimi por edhe të gjithë studentëve të programeve që ofrohen në UART është edhe Biblioteka e UART.</p> <p>Gjatë vizitës në Bibliotekën e UART-it, GVJ-së ju sqarua dhe ju komunikua se Biblioteka e Universitetit të Arteve ka në përbërje të saj dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e fondit të hapur dhe salla “Media Library”, të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi.</p>





	<p>Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, office, punë kërkimore shkencore, etj. Pra, në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART-it.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ-së poashtu iu sqarua se shërbimet elektronike të Bibliotekës së Universitetit ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve, të cilat janë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) te sistemi i menaxhimit të integruar përmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin elektronik të fondit fizik të titujve të disponuar, kartelave elektronike, qarkullimin, etj., si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) të titujve për audiencën e gjerë; 2) te sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale).
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UART shërben edhe si arkiv FAB/UART, sepse sipas politikës së ruajtjes së trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore, atë e bëjnë nëpërmjet depozitimit të materialeve të bëra ndër vite.</p> <p>Përgjithësisht ajo që Biblioteka e UART-it bën, pra ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si salla me fond të hapur (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë cka studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e artit pamor)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Hapësira multimediale e Bibliotekës të UART ofron kushte komode. Kjo sallë ishte e pajisur me teknologjinë e re, dhe ishte në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, dhe studiuesve të artit, tërësisht pa pagesë. Statistika për përdorimin e kompjuterëve ishte afërsisht nga 90 – 100 përdorues në ditë. Kjo sallë përveç arkivës digjitale, disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në shirita në bobina, pllaka gramafoni, kasete, CD e DVD. Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur". Qëllimi i kësaj arkive është që të ofrojë akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjithë audiencën e Bibliotekës së UART.</p> <p><i>Referoju Bibliotekës online ne</i> http://uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=70&niveli=56</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Edhe përgjatë vizitës së GVJ-së në Bibliotekën e UART-it, konstatoi se Biblioteka e UART-it ka dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library", të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafike dhe Mësuesi"</p> <p>GVJ vërejtë se në ambientet e bibliotekës ndodhej "Salla</p>

	<p>Multimediale” e cila është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet të pajisur me softëare specifik në mbështetje të punës studimore në fushën e muzikës.</p> <p>Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj..</p> <p>Gjithashtu në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së UART, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p>Sipas statistikave ato disponojne:</p> <p>Salla me fonde te hapura 4 kompjutera per perdoruesit</p> <p>Salla multimediale 20 kompjutera</p> <p>Zyrat e perpunimit te informacionit - 6 kompjutera</p> <p>Katalogu online - 2 kompjutera</p> <p>Paisje multifunksionale printera-skaner fotokopje 2 cope Skanera 3 cope</p> <p>Printera 3 cope</p> <p>Servera 3 cope</p> <p>Raku - amafon, manjetofon, kasetofon</p> <p><i>(Shih Evidenca 5.16....Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UART-it funksionon bazuar në përcaktimet e Statutit të UART-it, Neni 21 dhe rregullores së bibliotekës. Në përputhje me sa më sipër, biblioteka qëndron e hapur duke nisur prej orës 08:00, orë në të cilën nis edhe procesi mësimor, e në vazhdim. Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART, për të plotësuar kërkesat e shtuara të studentëve dhe stafit akademik, punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UART</p> <p>Biblioteka e UART, e klasifikuar në llojin Bibliotekë Universitare, luan rolin e një biblioteke speciale për të gjitha fushat e artit në Shqipëri dhe ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në edukimin dhe formimin e artistëve. Mbështetja e procesit mësimor, veprimtarisë krijuese artistike-shkencore si dhe shërbimet që ofron ndaj kërkuesëve e artistëve nga institucione të ndryshme të artit janë parimet bazë të funksionimit të saj.</p> <p><i>Evidence. Nr. 7. Statuti i UART</i></p> <p><i>Evidenca 42.1. (Rregullorja e funksionimit të bibliotekës UART)</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit,</p>	<p>GVJ ju komunikua se Biblioteka e UART informon rregullisht Njësitë Bazë për mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Bazuar në njoftimin e bibliotekës, DAA paraqet kërkesat e saj për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të Programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafike dhe Mësuesi”. Gjithashtu, biblioteka raporton për fondin fizik në dispozicion (tituj, tekste, drama, revista, buletine, etj) dhe frekuentimin e ambienteve të bibliotekës sikurse dhe online.</p> <p>Disa nga menyrat e pasurimit të bibliotekës janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Blerje të univiersitetit 2. Donacione nga individë 3. Projekte

<p>duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>4. Huzime dhe shkembime nderbibliotekare</p> <p>2) Proçedura e porosise se librave (kerkesa nga pedagogu ne departamenti-percejllja ne biblioteke-foto e librit). Çdo ditë punonjesja e bibliotekes ben rregjistrimet te çdo libri që kërkohet nga përdoruesit e bibliotekës dhe nuk është pjesë e fondit aktual të saj.</p> <p>GVJ ju komunikua se Shefat e departamentit vijnë regullisht në bibliotekë ku verifikojnë literaturën përkatëse të degëve të tyre dhe bëjnë kërkesat specifike. Rasti i fundit ka qenë me Prog. e stud. Të Fotografisë, kur biblioteka i plotësoi të gjitha këkesat për titujt e librava mbi fotografinë të kerkuar nga Shefi i Departamentit.</p> <p><i>Evidence. Nr. 42. Lista gjithë përfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART'</i> <i>Evidenca 42. 2. Statistika te aksesit të Bibliotekës së UART</i> <i>Evidenca 42. 3. Procedurë dhurimi për Bibliotekën</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p> <p>Në përgjithësi GVJ deklaroi se literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde. Biblioteka siç na u prezantua gjatë vizitës dispononte literaturë bazë dhe ndihmëse siç parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara. Pavarësisht se departamenti dhe institucioni e kanë të përfshirë në planin strategjik të tyre, përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet literaturës të azhurnuar të 5 viteve të fundit, GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme të blerjes së literaturës që paraqitet sipas kërkesave të stafit pedagogjik, në bazë të fushës përkatëse. Gjatë vizitës në institucion, në bazë të diskutimeve të zhvilluara me stafin, blerja e literaturës në disa raste, nuk kishte qenë e mundur, gjë që ndikohet dhe diktohet nga procedurat ligjore të blerjes së librave.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="547 1339 722 1406">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="730 1339 962 1406">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="970 1339 1169 1406">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="547 1406 722 1435"></td> <td data-bbox="730 1406 962 1435"></td> <td data-bbox="970 1406 1169 1435">x</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			x
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		x					


<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në DAA garantohet nga Rregulloret përkatëse, mbi të gjitha nga Rregullorja e Sekretarisë mësimore. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa» Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit.</p> <p>a) ëeb-it te UART (http://vëë.umt.edu.al/)</p> <p>b) Komunikimit nëpërmjet postës elektronike (të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe studentët depozitojnë pranë sekretarisë mësimore adresën e postës elektronike);</p> <p>c) Sistemit të brendshëm PITAGORA (të gjithë anëtarët e e stafit akademik dhe studentët janë të aksesuar në sistemin e sipërpërmendur). Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në DAA përdoret sistemi Pitagora, i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i FAB, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi (Shih Evidencë RVB; Vizita në institucion)</p> <p><i>Evidenca 48. Rregullorja e funksionimit te Sekretarise Mesimore FAB</i> <i>Evidenca. Nr. 11. Rregullorja FAB</i> <i>Evidenca 48. 1. Screenshot nga regjistri i FAB</i> <i>Evidenca 48. 2. Screens hot nga komunikimi me email me studentet dhe pedagogët e FAB</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i informacionit synon të kontribuojnë në menaxhimin si duhet të institucionit. Sistemi Pitagora është një sistem i ri, i cili është vënë në funksion në këtë vit akademik. Para këtij Sistemi, UART ishte një nga Institucionet e para e cila përqafoi sistemin elektronik ESSE 3. Edhe pse sistemi i përdorshëm tani, ai Pitagora është në përmirësim të vazhdueshëm dhe GVJ është i mendimit se ky sistem shërben për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Akcesi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet sekretarisë mësimore, e cila ka një hyrje dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse</p> <p>Sigurimi i informacionit, për personelin akademik dhe studentet, realizohet nëpërmjet sistemit PITAGORA të implementuar pranë FAB në Universitetin e Arteve Tirane. Ky sistem siguron një sërë të dhenash si:</p> <p>a) Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marre dhe librezën e notave;</p> <p>b) Shkarkimin e vertetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët;</p> <p>c) Njoftimin në kohë reale të notave apo rrethimeve të tjera të vlerësimit të studenteve.</p> <p>Njeherazi, nëpërmjet web-it të Universitetit të Arteve, është i mundur sigurimi i informacionit dhe dokumentacioneve të nevojshme për studentet dhe stafin akademik. (Evidencë Vizita në institucion)</p>

	(Evidenca 43. <i>Manuali Pitagora</i>) (Evidencë. Nr. 48. 3 <i>Screenshot nga sistemi Pitagora</i>)			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ ju komunikua se Sistemi i integruar Pitagora është një platformë e cila siguron këmbimin e informacionit mes studentit, sekretarisë FAB, pedagogut. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem. Ky sistem siguron një sërë të dhënash si: <ul style="list-style-type: none"> - Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave; - Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; - Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimit të studentëve. <i>(Shih Evidencë 5.22....Manuali Pitagora)</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Duke iu referuar RVB, sistemi i menaxhimit në FAB, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët <i>(Evidencë RVB)</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Webfaqja e UART-it është e mirëorganizuar dhe ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi". Gjithashtu, nëpërmjet webfaqes, mund të përfitohet informacion i zgjeruar për stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimet e bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Institucionit. Ndërkohë, në webfaqe ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për aktivitetet e tyre të përditshme. Për informacionet e përgjithshme webfaqja mund të aksesohet nga çdo përdorues, pa limitime aksesi. Disa informacione në webfaqe ofrohen edhe në gjuhën angleze.			
Konkluzione	GVJ konstaton se UART disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. <i>Rekomandohet që web faqja e UART-it të jetë edhe në variantin anglisht në tërësi në mënyrë që të jetë i qasshëm i gjithi edhe për të huajt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Hartimi i Projekt Buxhetit afatmesëm dhe buxhetit të përvitshëm, përpos planifikimit të fondit të pagave për stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, bazohet në kërkesat e Njesisë Bazë FAB.</p> <p>Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj, Njësia Bazë DAA përqëndrohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimin e stafit akademik më kohë të plotë; 2. Sigurimin e bazës materiale; 3. Parashikimin e mbështetjes së veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor. <p>Projektbuxheti, parashikon të gjitha kostot e mbulimit financiar të programit të studimit dhe pasi miratohet në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrit, i përcillet për miratim përfundimtar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 63. Paraqitja e buxhetit nga administratori FAB</i> <i>Evidenca 63. 1 VBA për miratimin e buxhetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe, teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të</p>	<p>GVJ ju komunika se në hartimin e projektbuxhetit dhe mbështetjen efektive financiare të programit të studimit merren parasysh kërkesat e paraqitura nga Njësia Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”.</p> <p>Pra, përveç detajimit të kërkesave për PBA, përpara fillimit të çdo viti akademik, Njësia Bazë paraqet kërkesën për stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesëshme. Financimi i stafit akademik me kohë të plotë sigurohet nga buxheti i shtetit ndërkohë që stafi akademik me kohë të pjesëshme mbulohet financiarisht nga të ardhurat e vetë institucionit. Gjithashtu institucioni, bazuar në planifikimin financiar, siguron mbështetjen financiare për të gjitha shpenzimet.</p> <p>e tjera që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>(Referoju Evidencës 5.26 paraqitja e buxhetit nga administratori i FAB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ deklaroi se UART, për periudhën në të cilën shtrihet edhe vlerësimi i programit në kuadër të akreditimit, nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.</p> <p>Në bazë të VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në Sektorin publik”, pika 1,b.- Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen nga financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësive të auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj I veçantë, UART nuk plotëson kushtet për të</p>

	<p>patur një Struktur të Auditimit të brendshëm. Pavarësisht sa më lart UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 63. 4. Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020</i> <i>Evidencë. Nr. 5. 30. VKM NR. 83, datë 03.02.2016</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ-së ju komunikua se raportimi zhvillohet nga Bordi I Administrimit si organi më I lartë financiar i Institucionit. Miratime, shpërndarje grantesh, ndryshime për shpërndarje të të ardhurave pasqyrohen online me vendime nga Bordi i Administrimit dhe ekzekutohen nga Drejtoria e financave.</p> <p><i>(Evidenca 63. 3 Të ardhura që parashikohen të realizohen nga Universiteti i Arteve në periudhën Janar-Maj 2022)</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Poashtu GVJ-së iu komunikua se deri më tani institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë në përmirësimin e situatës financiare. Gjithësesi Departamenti i Arteve të Aplikuara/FAB në përmbushje të misionit për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore si në kushte e në mjete moderne të teknologjisë ka apikuar me projekte të cilat do të ishin një burim shtesë të ardhurash.</p> <p><i>Evidencë 63.2 Rishpërndarja e të ardhurave dhe shtesa në regjistrin e prokurimeve</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p> <p>GVJ u interesua pse UART nuk zhvillon auditim dhe përgjigja ishte se , UART nuk plotëson kushtet për të patur një Strukturë të Auditimit të brendshëm, mbështetur në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në Sektorin publik”, pika 1, b. - <i>Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçant.</i></p> <p>Megjithatë UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Gjatë vizitës vërtetuar si GVJ se UART ka dokumentacion që rregullativ që për mbulesë ka studentët nga hyrja e deri në dalje. Institucioni në fjalë ka politika e procedura në të cilat mbështetet cikli i plotë i programit të studimit siç vijon: Statuti i UART Rregullorja e Institucionit Rregullorja e Fakultetit të Arteve të Bukura Rregullorja e Ciklit të Dytë të Studimeve Rregullorja e programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi” Rregullorja e Sekretarisë mësimore etj. Këto rregullore që përmendëm më sipër, janë të mbështetura konform Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Akteve nënligjore në fuqi si dhe janë të miratuara me Vendim të Senatit Akademik. Poashtu ky institucion gëzon Statusin e veçantë që në muajin mars, të vitit 2021, sipas VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Evidencë Nr. 7. Statuti i UART Evidencë Nr. 10. Rregullore e UART</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç na u tha gjatë vizitës nga stafi akademik e studentët por poashtu siç edhe është shprehur në RVB, Fakulteti i Arteve të Bukura, UART, vizion të tij ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik-shkencor; - të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; - të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; - të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; - të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; - të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik-shkencor; - të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë; - të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të

	<p>artit e kulturës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; - të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën; <p>UART mundohet që në përgjithësi të jetë sa më transparente me studentët, I paanshëm, dhe të përdorë parimet e kritere si barazia, ndershmëria, informimi zyrtar dhe public, njoftimet, etj., prej të cilave ruhet baraspesha mes aktorëve kryesorë brenda e jashtë institucionit. Kriteret, procedurat, kërkesa për transferim dhe të gjitha rregulloret e aktet rregullative janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve, si edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të këtij Institucioni.</p> <p>Evidencë Rregullorja e FAB http://uart.edu.al/index.php</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në komunikim me stafin, GVJ-së, ju komunikua se në disa drejtime, pranimet e studentëve në FAB, ashtu si edhe në të gjitha programet që ofrohen në UART zhvillohen me Konkurs.</p> <p>Kriteret e pranimit për ciklin e dytë të studimeve, pjesë e të cilit është edhe programi, objekt vlerësimi, MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", pasi miratohen në Senatin Akademik bëhen publike. Çdo student i interesuar mund ta ketë këtë informacion si në faqen e web-it të UART-it, poashtu edhe në Sekretarinë mësimore të Fakultetit, por edhe nga përgjigjet që jep Sektori mësimor përmes email-it ose në inbox të faqeve sociale si FB dhe IG.</p> <p>Siç e shohim të paraqitur në RVB, poashtu është thjeshtë e verifikueshme, duke parë Rregulloren e programit të studimit, kriteret për regjistrimin e studentëve gjenden si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në UART, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve" bëhet me konkurs. -Ky konkurs organizohet në zbatim të rregullores dhe kritereve të propozuara nga njësisia bazë, Departamenti i Artit Aplikativ, kritere të cilat miratohen në Dekanat. Më pas, përcillen për miratim në Senatin Akademik të UART-it. -Pra në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", kriter pranimi është njohja nga kandidati e një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. -Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve "Bachelor" dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në Statutin e UART si dhe në rregulloret dhe kriteret e miratuara në Senatin Akademik të UART-it, ka të drejtë të konkurojë për t'u pranuar (të ndjekë) studimet në këtë program studimi. Vlerësim avantazhues për pranimin në studimet e këtij Masteri është studimi i plotë i programit Bachelor në Pikturë Grafikë dhe kritere të tjera që përcaktohen qartë në rregulloren e FAB. -Pjesë e pandarë e kritereve është, pa dyshim, testimi i talentit të kandidatit. -Pra të drejtën e konkurimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë "Bachelor" të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

	<p>-Studimet në këtë program mund t'i ndjekin edhe:</p> <p>a) studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>b) shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.</p> <p>- Departamenti i Arteve të Aplikuara përcakton kuotat e pranimit, tarifat e pagesave, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.</p> <p>- Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit, pasi miratohen nga Senati akademik i UART, bëhen publike në:</p> <p>a) webfaqe të Fakultetit;</p> <p>b) në ambientet e përcaktuara të njoftimeve për secilin Fakultet.</p> <p>- Në zbatim të Urdhrit të Rektorit mbi marrjen e masave të konkurseve të pranimit, Dekanati i Fakultetit të Arteve Aplikative, me anë të një urdhri të posaçëm për këtë procedurë ngre grupin e punës si dhe përcakton detyrat dhe afatet në zbatim të akteve nënligjore për konkurset e pranimit. Në këtë urdhër janë të përcaktuara të gjitha detajet për organizimin dhe mirëfunksionimin e stafit administrativ dhe stafit akademik.</p> <p>- Ky urdhër publikohet në rubrikën njoftime në ambientet e Fakultetit të Artit Aplikativ si dhe në të gjitha faqet elektronike të Institucionit.</p> <p>(Evidencë Rregullorja e FAB, neni 11)</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, kriteret, procedurat e pranimit, të transferimit të studimeve, si dhe kriteret e diplomimit janë të përcaktuara qartë në këtë Rregullore. Kjo rregullore është e miratuar me VSA Nr 37, datë 20.07.2022</p> <p>Të gjitha sipër janë të shtjelluara sipas neneve dhe konkretisht:</p> <p>Pranimi i studentëve, neni 11</p> <p>Regjistrimi i studentëve, neni 12</p> <p>Transferimi i studentëve, Kreu IV, neni 25</p> <p>Diplomimi i studentëve, Kreu VIII, neni 31</p> <p>Evidencë Rregullorja e programit të studimit MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi"</p> <p>Evidencë, Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 24</p> <p>Evidencë, Nr. 13. Rregullore e Prog. Stud.</p> <p>Evidencë, Nr. 43.1 Manuli i transferimeve</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UART në përgjithësi por DAA në veçanti si Njësia kryesore e ofrimit të këtij programi studimi informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, të cilat bëhen publike në:</p> <p>-në faqen webfaqen e Fakultetit, si dhe</p> <p>-në ambientet e përcaktuara pranë FAB.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju tha se në mbështetje të informimit</p>

	<p>të publikut si dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon përpara fillimit të çdo viti akademik, takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet Master, duke u shpjeguar kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve etj. Për shkak edhe të natyrës specifike të programit, studentët që ndjekin studimet e cilit të parë bachelor, janë pothuajse të gjithë të interesuar të ndjekin edhe studimet e cilit të dytë Master. <i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master neni 11)</i> <i>(Evidencë 3.8.... VSA për miratimin e krítereve të pranimit)</i> <i>(Evidenca 6.1....Urdhër i Dekanit DAA për komisionet e pranimeve 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Po ashtu GVJ-së, ju komunikua se në DAA nuk parashikohen kuota për studentët me aftësi të kufizuara. Kjo vjen edhe si pasojë e specifikës së programit. Për studentët që vijnë nga shtresa sociale "Rome/Ballkano-Egjiptiane", FAB/UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. <i>Evidencë. Nr. 45. 1. Kuotat e kërkuara në MAS nga Fakulteti i Arteve të Bukura për vitin akademik 2020-2021</i> <i>(Evidencë.3.9.....VKM për përjashtimin e nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano –Egjiptianë.)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, të drejtën e konkurimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi. Bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi, studimet në DAA mund t'i ndjekin edhe studentë shtetas të huaj. Studimet në DAA si program të dytë studimi, mund t'i ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt konkursit të pranimit si dhe pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik. <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullore e Programit të Studimit nen 11. Pika 7</i> <i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 24</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UART bazohet në një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara. PTë tjerë studentë që vijnë nga shtresa sociale "Rome/Ballkano-Egjiptiane", UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. UART zbaton anën ligjore dhe nënligjore, procedurën për pranimin e dokumentacionit, për secilin aplikues sipas kategorive, dhe miraton përfituesit. Kjo kategori përfiton bursë në masën 100% ose 50%. <i>(Evidencë. Nr. 63. 7. VBA 28 dt 30/12/2021)</i> <i>(Evidencë 3.9....VKM për përjashtimin nga pagesa të studentëve</i></p>

	Romë/Balkano-Egjiptianë)		
Konkluzione	Në fund GVJ konstaton se DAA si dhe Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", ka hartuar politika dhe procedura për pranimin e studentëve duke i ndjekur me rigozitet dhe duke i zbatuar ato.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			x

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

Poashtu GVJ konfirmon se kriteret dhe procedurat e kalimit të studentëve nga njëri vit akademik në tjetrin janë të rregulluara sipas Rregullores së programit të studimit MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi". Në këtë Rregullore janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, etj.

Gjithashtu GVJ-së iu bë e ditur se përmes sekretarisë mësimore, faqes së web-it të UART-it dhe sistemit PITAGORA, jepet informacion për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në një tjetër. Studentët informohen në detaje lidhur me vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik; për numrin e krediteve të akumuluar; për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj.

(Shih Evidencë 2.3.Rregullorja FAB)


(Shih Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

GVJ konstaton se mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, kriter bazë për pranimin në studimet e këtij programi studimi, MA në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", është studimi i plotë i programit Bachelor në Pikturë G dhe kriteret e tjera që përcaktohen qartë në rregulloren e UART. Kriteri kryesor është konkursi për tu pranuar në këtë program studimi.

Sipas RVB, çdo person/ kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve "Bachelor" dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në Statutin e UART si dhe në rregulloret dhe kriteret e miratuara në Senatin Akademik të UART, ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar (të ndjekë) studimet në këtë program studimi. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë "Bachelor" të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>Studimet në këtë program mund t'i ndjekin edhe:</p> <p>a) studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>b) shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.</p> <p>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore e Fakultetit të Artit Aplikativ i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Pedagogët e lëndës, për secilin program studimi, kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimi sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit.</p> <p>GVJ ju komunikua se në FAB, mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla (ose të mëdha) për lëndët artistike/lëndët e formimit bazë. Pedagogët në mënyrë individuale kryejnë informimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, programin lëndor, sezonin e provimeve, sistemin e vlerësimit dhe detyrimet vjetore që ka studenti në lidhje me programin/fushën specifike ku ai studion.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi". Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 20 kredite ECTS, nga të cilat tema teorike ka 4 kredite dhe Projekti artistik ka 16 kredite.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e realizimit të temës së diplomës dhe diplomimit u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet Departamentit të FAB, në mënyrë të vazhdueshme, duke ju dhënë informacione të detajuara lidhur me përgatitjen dhe procesin e diplomimit. Gjithashtu studentëve ju jepej informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomimin si dhe për politikën e plagjaturës.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ-së ju sqarua mënyra se si funksiononte UART në përgjithësi, DAA dhe Departamenti i DAA në veçanti për mënyrën sesi ky institucion mundohet të tërheqë sa më shumë kandidatë për studentë në programet që ofron. UART ka ngritur struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Faqja zyrtare www.uart.edu.al, panairët e organizuara nga MAS, si dhe faqja më e re e informimit matura shtetërore, në portalin U-Albania, japin informacionin e duhur ku në kohë reale kandidatët pyesin dhe marrin përgjigje për secilën problematikë të ngritur prej tyre. Administrimi i kësaj faqeje bëhet nga zyra e Sektorit mësimor dhe informimit të studentëve në bashkëpunim me Sektorin e TI.</p> <p>Për një informacion edhe më të madh përdoren edhe rrjetet sociale Facebook, LinkedIn, Google+, Youtube, Instagram.</p> <p>Në UART synohet informimi i nxënësve që kur janë në shkollë të mesme për ti nxitur që të mund të ndjekin talentin e tyre në fushën e përzgjedhur.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ shprehet se UART-i në përgjithësi dhe FAB-i në veçanti, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë</p>

	<i>e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve e deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit të tyre në drejtimin përkatës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre</p> <p><i>(Evidencë Takime në institucion).</i></p> <p>Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahej edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj</p> <p><i>(Evidencë Takim në Sekretarinë Mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët përveç informimit të tyre nga pedagogu i lëndës në lidhje me modulet, lëndët, veprimtaritë formuese të programit, etj është edhe faqja web e UART www.uart.edu.al</p> <p>Studentët mund t'i qasen gjithë informacionit që dëshirojnë rreth programit të studimit, nëpërmjet kësaj webfaqeje.</p> <p>Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret edhe Sistemi Pitagora, sistem i cili është bërë i mundur të aplikohet nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) për të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë public që kanë dashur të jenë pjesë e këtij Sistemi.</p> <p><i>(Shih Evidencë Takime në institucion; RVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjithmonë duke ju referuar RVB por edhe në bisedë gjatë vizitës si RVJ, shohim se programet dhe riorganizimi i tyre, janë të përshtatshme për t'iu përgjigjur tregut të punës. Këtij qëllimi i ka shërbyer Urdhëri i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 dhe Nr. 512, datë 24.10.2019, si dhe zbatimi i Udhëzimit të MASR Nr.52, dt.03.12.2015, i ndryshuar për gjuhët e huaja. Përgjatë viteve akademike, pjesë e procesit të akreditimit, janë diplomuar në programin MA në "Pikturë Grafike dhe Mësuesi", si më poshtë:</p> <p>2018 – 2019 janë diplomuar 6 studentë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>2019 – 2020 janë diplomuar 3 studentë 2020 – 2021 janë diplomuar 3 studentë 2021 – 2022 janë diplomuar 8 studentë Po ashtu informohemi si GVJ se numër i konsiderueshëm të këtyre studentëve janë të punësuar në profesionin për të cilën kanë studiuar.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testimeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, mund të aksesohen në ambientet e hapura në Fakultetin e Arteve të Bukura, po ashtu edhe nëpërmjet faqes web të institucionit. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore e FAB.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Webfaqja e UART-it ka informacionin për programet e studimit, është publik dhe mund të aksesohet prej kujtdo në çdo moment në faqen e internetit, nga çdo pajisje dhe nga çdo vend i mundshëm. Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, aksesojnë sistemin Pitagora përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Qasja është elektronike dhe studentit mund ta përdori sistemin nga të gjitha formatet elektronike, qofshin ato smartphone, tablet, PC, etj., mjafton që studentit të ketë akses në adresën e tij elektronike dhe të vendosë fjalëkalimin e saktë. Gjithashtu studentët na deklaruan se nga ana e pedagogëve përkatës, në fillim të çdo semestri njihen me të gjithë programet lëndore (syllabuset), ku jepen të detajta detyrimet e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UART vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave të studentëve si ato që ndjekin programin e studimit por edhe atyre studentëve që janë diplomuar është sekretaria mësimore e DAA e cila funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

	<p>dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit apo edhe të transferimit. Në periudhën 2018-2019 gjithmonë sipas të dhënave gjatë vizitës në institucion janë diplomuar 5 studentë nga të cilët 1 student pa prapashtesën “Mësuesi”, pasi në vitin 2018 ishte bërë riorganizimi i programit. Ndërsa të katër studentët tjerë janë me prapashtesën “Mësuesi”. Mbatja e statistikave të studentëve mbahet edhe në Sektorin e Statistikave, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore. Të dhënat ruhen në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”. Regjistrimet, përfshirë transferimet, për studentët të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, si dhe studentët e diplomuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit, paraqiten si vijon:</p> <p>Viti akademik 2019-2020 2020-2021 2021-2022</p> <p>Studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë 6 8 7</p> <p>Studentë të diplomuar 3 3 8</p> <p><i>(Shih Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ dekalron se Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në regjistrat përkatës) si dhe në Sistemin e Pitagora, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj. përmes sistemit</p> <p><i>(Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të</p>	<p>Me Vendim të Senatit Akademik Nr 21, datë 07.10.2021, në Universitetin e Arteve, është miratuar Rregullorja e Sektorit Mësimor, e cila përcakton se është ky sektor që kryen kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>Gjatë takimit me këtë Sektor, GVJ u informua se ky sektor kryen herë</p>

dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>pas here kontrole në përfundim të vitit akademik, në sekretaritë mësimore duke vëzhguar nga afër regjistrat e arritjeve akademike (regjistri i notave) duke krahasuar një sistem të rastësishëm se si janë hedhur notat në këtë regjistër nga stafi i sekretarisë. Është fakt, që nuk është vërejtur asnjë problem serioz në keq hedhjen e notave apo edhe të ndryshimit të tyre.</p> <p><i>(Shih Evidencë 6.7....Rregullorja e Sektorit Mësimor UART)</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë takimeve në Institucion, GVJ u takua që në takimin e parë me përgjegjësin e Departamentit të FAB, i cili bëri një pasqyrim në lidhje me punën e tij por edhe me mbarëvajtjen e këtij Departamenti. Po sipas Përgjegjësit të Dep, realizohet për çdo vit akademik një raport analitik, kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Në këtë Raport paraqitet dhe pasqyrohet në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike në Departamentin e FAB-it, procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, përqindjen e të diplomuarve, numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UART, pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p>Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e tyre të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim, si dhe me marrjen e mndimit të tyre në lidhje me vlerësimin e dijeve dhe aftësive që ato kanë marrë gjatë periudhës së studimeve në FAB. Propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të kanë qënë gjithmonë të mirëpritura.</p> <p><i>(Shih Evidencë Nr 2.12....raporti i analizës vjetore FAB)</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se të dhënat për studentët që në regjistrimin e tyre dhe deri në përfundim të studimeve janë të mirëmbajtur nga Sekretaria Mësimore e FAB.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni</p>	<p>GVJ iu tha se që me miratimin e Statutit të ri të UART të MASR Nr</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423




web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>3937/5, datë 15.09.2021, me VSA Nr 15, datë 30.08.2021, studentët përfaqësohen në Senatit Akademik të UART prej 19 anëtarësh me 2 studentë, duke forcuar zërin e tyre në ngritjen e problemeve por edhe duke patur në konsideratë edhe zgjidhjen e tyre. Studentët përfaqësohen në të gjitha nivelet në UART, duke filluar që nga Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli studentor, etj. (Shih Evidencë 1.15.....Statuti i UART Kreu IX, neni 126)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ iu komunikua se me vendim të Senatit Akademik Nr 22, datë 07.10.2021 është miratuar Rregullorja e Komisionit të marrëdhënieve me studentët. Objekti kryesor i ngritjes së këtij komisioni është sigurimi në një nivel cilësor i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët, pedagogët përkatës si dhe njësitë e brendshme të ngritura në UART, duke garantuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UART dhe të studentëve të tij. Misioni i këtij komisioni është bashkërendimi I punës së stafit akademik, stafit administrativ dhe e studentëve si dhe monitorimi I zbatimit të procedurave të aprovuara nga organet drejtuese për të gjithë procesin mësimor në aspektin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Studentët përfshihen edhe në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor mbledhin të dhëna për secilën lëndë, secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset. Për gjetjet e sondazheve, i është dorëzuar një raport edhe Rektorit të UART. Një tjetër formë është dhe ajo e përfaqësimit me një anëtar grupi pune në grupet e punës të vlerësimit të brendshëm të akreditimeve të programeve apo akreditimit institucional. Edhe në hartimin e këtij raporti të vlerësimit të brendshëm, është përfshirë një student nga Programi i Studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi".</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin mësimor, GVJ u informua se në Universitetin e Arteve, si një institucion me veprimtari specifike siç është fusha e artit dhe me një numër të kufizuar studentësh, njësia përgjegjëse që garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi është Sektori Mësimor. Ky sektor, organizon sondazhe nëpërmjet pyetësorve për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien, programet e studimit, facilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera. Gjetjet e këtij raporti i bëhen të ditura nëpërmjet një raporti Rektorit të UART.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit. Në Rregulloren e programit të studimit të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr 37, datë 20.07.2022, neni 21, përcaktohet se studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni i provimit jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni është i detyruar të sqarojë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjen e dokumentuar ose rregjistrimet (kur ka) të studentit më tezën e zgjidhur. Në rastet e kontestimit të rezultatit, në Komision duhet të marrë pjesë edhe Përgjegjësi i Departamentit, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit ndjek procedurën e përcaktuar në rregullore për trajtimin e ankimimeve duke garantuar transparencë dhe barazi (Shih Evidencë Rregullore e Programit të studimit, neni 21, pika 11,12,13).</p> <p>Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p>								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se DAA përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre..</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion pati mundësinë që përveç Sektorit mësimor, Sekretarinë Mësimore, të takonte edhe përfaqësuesin e sektorit të projekteve.</p> <p>Gjatë takimit me këto sektorë, u informuam se Universiteti i Arteve ka ngritur njësi me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve siç janë: Sekretaria Mësimore dhe Sektorin Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe strukturën e “Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Koordinatorin i Institucional. Këto zyra ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i rregjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore.</p> <p>Sipas rregullores se sektorit mësimor, ky sektor ka si detyrë: Ndjekjen, gjurmimin dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar. Studentët e diplomuar të Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Kontributi i tyre në fushën e artit është i pazëvendësueshëm. UAR është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet:</p> <p>a) mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve;</p> <p>b) lehtësimin e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të arsimit të lartë dhe biznesit;</p>

	c) lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës. d) etj
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ashtu siç jemi shprehur edhe mësipër, GVJ shprehet dhe dëshmon se përveç Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin i Institucional, përdoret me efikasitet të plote faja e web-it të UART si dhe së fundmi sistemi PITAGORA në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqiptar. Në këtë system informohen studentët si për rezultatet e tyre ashtu edhe me gjithçka tjetër në lidhje me procesin mësimor.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë takimit me Sektorin Mësimor, GVJ ju komunikua se ky Sektor, ka pjesë të tij edhe Informimin e Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Specialist i këtj Sektori është edhe Koordinatori Institucional, që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Sektori mësimor një nga detyrat e tij ka edhe mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë; drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve; mbajtjen e komunikimit me tregun e punës, si dhe ofrimin e asistencës në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Po ashtu zyra ruan lidhje të ngushta me Këshillin Studentor dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, zyra bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t'u prezantuar atyre: institucionin, programet, mundësitë e punësimit etj.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë takimit me Sektorit mësimor, GVJ u informua se në përbërje të Sektorit Mësimor, funksionon edhe Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART. Kjo strukturë, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj. Për të shmangur të dhënat sensitive dhe për të garantuar ish studentët e UART, Sektori mësimor ka përgatitur një formular ku i fton ish studentët të plotësojnë me vullnet të lirë të dhëna që konsiderohen sensitive si numri i kontaktit apo edhe adresë email, duke i siguruar që këto të dhëna janë vetëm për database të Alumni të UART. Çdo vit, struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit, dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse (Evidencë 6.7....Rregullorja e Sektorit Mësimor UART)
Konkluzione	GVJ konstaton se në UART funksionon më së miri gjithçka që lidhet me studentët dhe me problemet apo edhe me specifikat e tyre si artistë të së nesërmes.
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet Përmbushet Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al



standardit	Përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së ju komunikua se për vetë specifikën e programeve që ofrohen, në UART mënyra më e mirë e zhvillimit të orës së mësimi është zhvillimi i mësimi në auditor. Kuptohet se gjatë vitit akademik 2019-2020 procesi mësimor dhe tërë veprimtaria akademike ishte kryer online në përshtatje me situatën e krijuar nga pandemia COVID -19. Organizimi i mësimi online ishte një metodë dhe një eksperiencë e re në zhvillimin e procesit të mësimdhënies jo vetëm nga studentët por edhe nga stafi akademik i UART-it. Në këtë kohë ishte ngritur dhe ishte vënë në funksionim sistemi Microsoft Teams i ngritur nga Rektorati dhe sektori i TI-ve. U dha në dispozicion manuali i përdorimit të këtij sistemi nga Sektori i TI si për pedagogët ashtu dhe për studentët.</p> <p>Poashtu GVJ-së ju komunikua se mbështetur në të gjithë format e komunikimit edhe studentët u përgatitën që provimet t'i jepnin online, me mënyra alternative, individualish apo me grupe të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në takimin me Komisionin Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë GVJ-së iu tha se një nga mekanizmat më të përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, janë sondazhet dhe pyetësorët të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor apo edhe nga vetë departamentet. Dallohej qartë që strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë njësitë bazë. Pra, këto Njësi apo Departamente mbështeten në strukturat përkatëse si Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe Informimit të studentëve si dhe Sekretariatë mësimore pranë secilit Fakultet, duke koordinuar punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Pra, ky institucion ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përfitimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>Disa nga format e veçanta të mësimdhënies në DAA janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike me studentë e pedagogë, -bashkëveprimi midis tyre në këto veprimtari -bashkëveprimi me departamente të tjera, <p>Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies organizohen edhe trainime të stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit. DAA ka zhvilluar disa takime në parim me Fakultetin e Shkencave Sociale për të mundësuar trajnime, seminare dhe konferenca me qëllim ngritjen e nivelit mësimdhënës të pedagogëve të rinj nga pikëpamja pedagogjike dhe përditësimi me idetë e reja të po këtyre aftësive pedagogjike ndër pedagogët tashmë me përvojë. Në plan ishte që pas këtyre takimeve për stafin akademik të shpërndahen edhe certifikatat përkatëse.</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në bazë të rregullativës së këtij Institucioni gjejjës por edhe e Fakultetit të Artit Aplikativ, garantojnë përfshirjen e studentëve si në vlerësimin periodik, ashtu edhe në mundësin e trajtimit të ankimeve. Përgjatë vizitës në Institucion GVJ-së iu tha se për vetë specifikën e procesit mësimor, ku studiot dhe atelietë janë laboratorë të mirëfilltë kërkimorë, procesi mësimor parashikon përfshirjen e studentit në çdo hap, nisur që nga paraqitja e programit të lëndës, hapat e realizimit të tij, te informimi për mënyrën e vlerësimit e deri te paraqitja e provimeve para publikut. Pra, studentët në UART kanë të gjithë vëmendjen e duhur si nga personeli akademik ashtu edhe nga ai administrativ.</p> <p>Njësoj siç jemi shprehur edhe në kriteret e mësipërme, GVJ deklaroi se studentët kanë të drejtë edhe të ankimit për vlerësimet e tyre, fillimisht në departamentet përkatëse, e më pas në Dekanat apo Rektorat.</p> <p><i>(Evidencë 2.2....Rregullorja e Ciklit të II-të të Studimit)</i> <i>(Evidencë 2.3....Rregullorja e DAA)</i> <i>(Evidencë 2.5....Rregullorja e Programit të Studimit RTSM)</i> <i>(Evidencë 2.7....Rregullorja e UART)</i></p>		
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Mbështetur edhe në RVB, GVJ shprehet se gjatë takimeve në Institucion, ju bë e qartë se rezultatet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorëve, bëhen publike nëpërmjet afishimit të tyre fizikisht në vende të dukshme në mjediset e brendshme të DAA-it, takimeve informuese me pedagogët dhe studentët, kontakteve me Këshillin Studentor të UART-it si dhe analizave vjetore të departamenteve. Ato publikohen periodikisht në faqen web të UART-it.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nxjerrja e rezultateve të monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet pyetësorëve, evidenton shembuj të praktikave të mira dhe brenda kufijve të etikës, duke nxitur stafin akademik për përmirësim të proceseve të mësimdhënies, të programeve të studimit dhe të vlerësimit të dijeve sipas kërkesave bashkëkohore.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pra krejt në fund GVJ deklaroi se DAA-i ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Në takimin me Dekanin dhe Përgjegjës të DAA-it, por edhe gjatë takimit me Komisioni Ad Hoc, GVJ iu komunikua se Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm është Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Organizimi dhe funksionet e komisionit janë të parashikuara në Statutin e UART.

(Evidencë Statuti i UART, neni 35)

Për Sigurimin e brendshëm të cilësisë, ishte ngritur edhe Komisioni Ad Hoc me Urdhër të Rektorit të UART.

Bazuar në atë siç ata u deklaruan, Komisioni bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UART. Ky Komision është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.

(Evidencë RVB; Manuali i Sigurimit të Cilësisë)

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

GVJ ju komunikua se duke qenë se Sigurimi i Cilësisë është një proces i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë të të gjithë Universitetit të Arteve në përgjithësi por edhe të të tre Fakulteteve, pjesë kryesore e këtij Universiteti, është menduar që në përvërjen e këtij Komisioni të jenë: Zv Rektori për anën mësimore, Zv Rektori për projektet artistike dhe shkencore, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Artit Skenik, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Arteve të Bukura, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Muzikës, si dhe i gjithë Sektori Mësimor&Kurikulës.

Pjesë e këtij Komisioni për DAA ishte Përgjegjësi i Departamentit të Arteve të Aplikuara, i cili ja shtjelloi gjerësisht GVJ-së, të gjithë specifikën dhe mënyrën e funksionimit të këtij Komisioni.

Duke iu referuar RVB-së, ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përmenden: Organizimi i Brendshëm të Cilësisë; Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Dokumenti kryesor që rregullon punën e këtij Komisioni është Manuali i Sigurimit të cilësisë.

Për vjeljen e informacionit mbi ecurinë e programit dhe performancën e personelit etj. përdor një numër vlerësimesh si:

- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies ;
- Vlerësimi nga studentët për institucionin;
- Vlerësimi i studentëve për programin;
- Vlerësimi i stafit për institucionin

	- Vlerësimi i Rektoratit për strukturat menaxhuese; Vlerësimi i stafit nga instancat drejtuese (Dekan/Zv.Dekan).		
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në këtë takim na u tha se sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohet nga vetë institucioni dhe menaxhohet nga Komisioni Ad Hoc. Pra, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi organizohet në mënyrë periodike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). UART-it i është akorduar riakreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.17, dt. 24.03.2022 duke e vlerësuar pozitivisht me vlerësimin maksimal, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Ndërsa programi i studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, ashtu si edhe të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në DAA por edhe në UART, po i nënshtrohen akreditimit për herë të parë të tyre.		
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Gjatë vizitës GVJ-së iu komunikua se praktika që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit, në funksion të rritjes së cilësisë, është e përcaktuar dhe në përputhje me Rregulloret për funksionimin e Fakultetit dhe Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor dhe Master. Një nga treguesit më të matshëm për cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies në Universitetin e Arteve, është punësimi i studentëve të tij si brenda dhe jashtë vendit, në institucione prestigjioze të fushës së arteve që përbën edhe një nga pikat e forta të diplomuarve në këtë program studimi. (Evidencë 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit) (Evidencë 2.5....Rregullorja e Programit të Studimit Master) (Evidencë 3.20....Vërtetim punësimi nga ish studentë)		
Konkluzione	GVJ deklaroi se UART zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin	Tutje, mbikëqyrja e herëpashershme e programit të studimit Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi” bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik (Evidencë Model Pyetësori). Vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Arteve të Aplikuara kryhet duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, të dhëna për zhvillimin e teknologjisë në vend lidhur me programet e studimit si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime. Siç u spjegua gjetjet dhe përgjigjet në këto pyetësor shqyrtohen në Departament duke shqyrtuar problematikat e hasura dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

<p>e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog. Departamenti analizon të gjitha elementët e realizimit të tij, si mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme.</p> <p>Për të bërë këtë analizë, departamenti mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritet mësimore. Departamenti shqyrton analizat e programeve të studimit që mbulon dhe përcjell në dekanat raportin e analizës mësimore të departamentit. Dekanati harton raportin e analizës mësimore të fakultetit, të cilën e përcjell në rektorat.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe takimeve në institucion, një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo viti akademik. Njësitë kryesore pasi marrin në dorëzim raportet, i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike, ku ftohen dhe përfaqësues të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të dhënë komentet përkatëse, dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për përmirësimin e situatës. Sipas RVB, në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjeshtar të stafit. GVJ u informua se mbi bazën e vlerësimeve të përsëritura negative, ka patur raste të mosrinovimit të kontratës për personelin akademik (<i>Evidencë Takim me Komisionin Ad Hoc</i>). Në disa raste, për të adresuar problematikat e konstatuara, janë zhvilluar trajnime si për shembull për kuptimin e kurrikulës nga stafi i ri, përdorimin e teknikave të mësimdhënies etj.</p> <p><i>(Evidencë RVB; Takime në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Duke iu referuar RVB-së, metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMNI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testimeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj.</p> <p>GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Komisionin Ad Hoc të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Referuar RVB, institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore,</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve ose në sipërmarrjet ku ata punojnë. Sektori Mësimor, Alumnit dhe Karrierës, realizon studime periodike të punësimit të studentëve dhe zotëron një databazë të studentëve të punësuar. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion (Evidencë Dosja e Vetvlerësimit, Takime në institucion).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se UART monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga Komisioni ad Hoc për Sigurimin e Cilësisë, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm kontribuojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. I gjithë aktiviteti i këtij Komisioni bazohet në Statutin e UART, bazën Rregullative të UART dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përfuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit (Evidencë Takime në institucion; Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me</p>	<p>Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit, Manualin e Sigurimit të cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, anëtarët e këtij komisioni dhe këtij sektori, kanë përgjegjësi dhe detyra</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al




përgjegjësi të këtyre detyrave.	konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit (<i>Evidencë RVB; Takime me GVB</i>).			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Grafikë dhe Mësuesi", në veprimtarinë e saj, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë mbështetet nga Universiteti i Arteve në përgjithësi si dhe nga Departamenti i Arteve të Aplikuara dhe Departamenti i DAA në veçanti. Në punën e saj ky Komision zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në RVB, Departamenti i Arteve të Aplikuara ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me artistë të njohur të fushave të ndryshme të artit si brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e mësidhënies si pedagogë me kohë të pjesshme. Nëpërmjet zhvillimit të shkëmbimeve të drejtpërdrejta me regjisorë, aktorë, pedagogë, dramaturgë vendit apo të huaj nga rajoni apo më gjerë, vazhdimisht merret ekspertizë e vlefshme lidhur me programet e mësimi, cilësisë dhe përafrimin e tyre me programet e IAL simotra dhe cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet ballafaqimit të nivelit të përgatitjes së studentëve në këto masterclass-e. Ekspertiza dhe sugjerimet e tyre vijnë nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. Në këto rast është konsideruar me prioritet opinionin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. (<i>Evidencë 4.1...Shfaqje apo takime me regjisorë/aktorë</i>)			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423




web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Faqja web e UART-it është lehtësisht e verifikueshme me të gjithë informacionin e saj. UART-i dhe DAA-i, ka në politikën e tij gjithë pjesën e transparencës për të gjithë aktet rregullativ, Vendime të Senatit Akademik, të Bordit të Administrimit si dhe çdo veprimtari tjetër të njësive të tjera, në faqen e web-it të universitetit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Gjithmonë sipas RVB-së, parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Sektorit Mësimor dhe të Kurrikulës si dhe në Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Janë këto parime që sigurojnë garantimin e transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit, për transparencë, ju ishte dërguar me e-mail të gjithë stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Fakultetit të Artit Aplikativ, një pjesë e të cilëve nuk ishin pjesë përbërëse e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga takimi në institucion GVB u informua për elementë të cilët kanë qenë në fokusin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit e që kanë rezultuar nga anketimet e kryera. Po ashtu në raportet e përgatitura për instancat e ndryshme ka elementë të rekomandimeve apo përmirësimeve të nevojshme. Një rol të posaçëm luan dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, si dhe Sektori i TI, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me përgjigjet e pyetësorëve. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, vlerësim i dhënë së fundmi, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Tutje, procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimin e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo, sipas RVB, realizohet përmes strategjive, matshmerisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimit të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative. Megjithatë, GVJ është i mendimit që, një proces i monitoruar në mënyrë më të përqëndruar, do të kishte një impakt më të mirë në përmirësimin e sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, organizojnë veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar për këtë qëllim. GVJ-së ju konfirmua nga disa drejtime se një sërë takimesh janë realizuar me stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm në kuadër të riakreditimit institucional të UART, proces i cili u mbyll me një vlerësim maksimal. Në kuadër të akreditimit për herë të parë të programeve të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423




E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al



	<p>studimit të ciklit të dytë, program i cili është edhe Master i Arteve në “Pikturë Grafikë dhe Mësuesi”, na u deklarua se janë zhvilluar një sërë takimesh me stafin akademik pjesë përbërëse të Grupeve të vlerësimit të brendshëm për të diskutuar, apo ndarë komente dhe pyetje të ndryshme në lidhje me të gjithë procesin e akreditimit. Një sërë takimesh janë realizuar edhe nga Komisioni AD Hoc i të gjithë procesit të akreditimit të programeve. Vetë përbërja e këtij Komisioni tregon për rëndësinë që ka sigurimi i Cilësisë në këtë Institucion.</p> <p>Megjithatë, edhe pse Grupit të Vlerësimit të Jashtëm Ju bë një paraqitje shumë e mirë e të gjithë punës së Komisionit AD Hoc për Sigurimin e Cilësisë, GVJ i rekomandon Universitet të Arteve, krijimin e një Njësie permanente për Sigurimin e Cilësisë, në përputhje edhe me Statutin dhe Organigramën të miratuar nga Ministria e Arsimit .</p> <p><i>(Evidencë Statuti i UART)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve/ Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Arteve"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Pika e parë e fortë e programit të studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është historia e institucionit, që prej krijimit të tij që në vitet '70, duke dëshmuar një vazhdimësi institucionale, përveç se artistike, duke e veçuar atë si i vetmi universitet me qasje artistike, në rang kombëtar.
2. Pika e dytë konsiston në kurrikulën e programit, është përshtatur me tregun e punës, ku gërshetohen dijet artistike me qasjen në mësuesi, duke mundësuar në këtë mënyrë, specializimin e mësuesve të ardhshëm, në gjithë nivelet e edukimit arsimor në gjithë vendin. Programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi mbështetet në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Arteve, Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020, në disa parashikime të Draft Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Në përputhje me strategjitë e parashikuara në nivel kombëtar dhe ato në nivel ndërkombëtar, programi i studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është konceptuar për tu përshtatur sa më shumë me tregun e punës, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët e mundshëm, dhe duke zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistiko- shkencor me Universitete dhe Institucione në Evropë duke ofruar mundësi ndërkombëtarizimi.
3. Institucioni ku programi i studimit Pikturë Grafikë dhe Mësuesi është i përfshirë, është pjesë e një sërë marrëveshjesh me institucione të tjera, përfitimet të cilat në vite kanë konsistuar në angazhimin e studentëve tanë në programin Erasmus Plus, angazhimin e tyre në punë part-time në institucione kulturore vendase, dhe angazhimin e tyre në dhjetëra aktivitete artistike, e didaktike të përbashkëta si ekspozita, ëorkshope, etj.


Pika të dobëta

1. Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës e bisedave në institucion, u konstatua se një pikë e cila kërkon reflektim, është statusi i universitetit. Duke kuptuar vetë natyrën e këtij universiteti, ky program ashtu si dhe programet e tjera të FAB, kërkojnë një bazë të fortë njohurive artistike dhe atyre shkencore, çka nënkupton se nevojitet një staf specifik. Në vitet e kaluara stafi akademik i UA, i konvertohej aktiviteti artistik në tituj akademik si (Prof. Asoc., Prof.), aspekt që sot Ligji për Arsimin e Lartë nuk e mundëson e vështirëson kualifikimin e stafit me titujt akademik. Ligji për Arsimin e ri aktual, si edhe marrja me statusit të veçantë të UA me VKM 145, ende nuk e ka zgjidhur këtë problematikë.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Arts in Graphic Painting and Teacher offered by HEI "University of the Arts"

STRENGTHS AND AFFIRMATIONS


1. The first strong point of the Painting, graphic and Teaching Study Program is its history, a traditional didactic structure built by the best professionals in the country since the



- 70s, and currently adapted to the demands of education and culture contemporary with some of the most important names of the art scene in the country, (and the scientific one) thus turning it into the unique and most precious destination on a national scale.
2. The second point consists in the curriculum of the program, it is adapted to the labour market, where artistic knowledge is interwoven with access to teaching, thus enabling the specialization of future teachers, at all levels of education throughout the country. The Master of Arts in Graphic Painting and Teacher study program is based on the Development Strategy of the University of Arts, the National Strategy for Development and Integration 2015-2020, in some predictions of the Draft National Education Strategy 2021-2026. In accordance with the strategies envisaged at the national level and those at the international level, the Master of Arts in Graphic Painting and Teacher study program is designed to adapt as much as possible to the labour market, creating equal conditions for all potential candidates, and developing cooperation relations in the field of education and artistic-scientific research with Universities and Institutions in Europe, offering opportunities for internationalization.
 3. The third point has to do with its communication and cooperation with all other actors, be they cultural, educational institutions, or certain sectors of the labor market. Thus, this program is included is part of a series of agreements with other institutions, the benefits of which over the years have consisted in the engagement of our students in the Erasmus Plus program, their engagement in part-time work in local cultural institutions, and their engagement in dozens of joint artistic and didactic activities such as exhibitions, workshops, artist talks, etc....

WEAKNESSES

1. According to the presented documentation and the visit to the conversations in the institution, it was concluded that a point that requires reflection is..the status of the university. Understanding the very nature of this university, this program, like other FAB programs, requires a strong foundation of artistic and scientific knowledge, which means that a specific staff is needed. In the past years, the academic staff of the AU converted their artistic activity into academic titles such as (Prof. Assoc., Prof.), an aspect that today the Law on Higher Education does not enable and makes it difficult to qualify the staff with academic titles. The current new Law on Education, as well as the special status of UA with VKM 145, has not yet resolved this issue.



Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve “Pikturë dhe Grafik dhe Mësuesi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”


Rekomandime

1. *GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme dhe konstante të njësisë bazë, duke e konkretizuar në mbështetjen financiare të stafit në hapjen e ekspozitave personale apo kolektive jashtë vendit, si dhe në mbështetjen e tyre në botimin e studimeve apo pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare sipas fushës përkatëse, aspekte këto, që do të ndikonin pozitivisht në përmirësimin e ecurinë e programit.*
2. *Gvj konstaton se programi i studimit ofron njohuri të avancuara, ndërkombëtarizim dhe kërkim artistik-shkencor. Pavarësisht kësaj, në bazë të vizitës në institucion, në bazë të diskutimeve me studentët e këtij profili, u ngrit si diskutim krijimi i njësisë kërkimore aplikative. Ngritja e një njësie të tillë do të ndihmonte akoma më shumë studentët dhe stafin në zhvillimin e kërkimeve dhe teknologjive të reja. Ngritja e një laboratorit duhet të jetë një hapësirë për të krijuar, për të mentoruar dhe për inovacion; një mjedis unik mësuesor ku studentët mund t'i transformojnë idetë e tyre në realitet përmes eksperimentimit, inovacionit dhe dizajnit. Kjo njësi e kërkimit aplikativ mund të angazhohet dhe botimin e punës kërkimore të Universitetit në periodikë të caktuar që ndiqen nga departamenti përkatës. Kjo njësi do të ofronte një qasje multidisiplinare në kërkimin artistik dhe shkencor, si dhe do të ishte e frytshme në ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të programit.*
3. *Në përgjithësi GVJ deklaron se literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde. Biblioteka siç na u prezantua gjatë vizitës dispononte literaturë bazë dhe ndihmëse siç parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara. Pavarësisht se departamenti dhe institucioni e kanë të përfshirë në planin strategjik të tyre, përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet literaturës të azhurnuar të 5 viteve të fundit, GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme të blerjes së literaturës që paraqitet sipas kërkesave të stafit pedagogjik, në bazë të fushës përkatëse. Gjatë vizitës në institucion, në bazë të diskutimeve të zhvilluara me stafin, blerja e literaturës në disa raste, nuk kishte qenë e mundur, gjë që ndikohet dhe diktohet nga procedurat ligjore të blerjes së librave.*
4. *Duke pas parasysh natyrën specifike që ka në vete vet Programi i Studimit Master i Arteve në Pikturë Grafikë dhe Mësuesi, si në anën organizative të mësimit në FAB, hapësirat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësuesor mundësojnë që të pranishëm*


të jenë një numër më i konsiderueshëm studentesh. Përgjithësisht FAB si institucion ka mjaftueshëm hapësira për t'iu përgjigjur ngarkesës mësimore. Pavarësisht kësaj, rekomandohet shtimi i hapësirave apo ngritja e një godine të re institucionale, pasi një pjesë e tyre janë tashmë të amortizuara. Duke patur parasysh dhe trendin në rritje të regjistrimit të studenteve në këte fushe, shtimi i hapësirave vjen si një nevojë. Rikualifikimi strukturor i godinës deri më tani është ngritur dhe rinovuar vazhdimisht me kontributin e vetë institucionit.

RECOMMENDATIONS

1. External evaluation group recommends the continuous and constant support of the basic unit, concretizing it in the financial support of the staff in the opening of personal or collective exhibitions abroad, as well as in their support in the publication of studies or participation in international conferences according to the relevant field, these aspects, which would positively affect the improvement of the progress of the program.
2. External evaluation group finds that the study program offers advanced knowledge, internationalization and artistic-scientific research. Despite this, based on the visit to the institution, based on discussions with students of this profile, the creation of applied research units was raised as a discussion. Setting up such a unit would further assist students and staff in developing research and new technologies. Setting up a lab should be a space to create, mentor and innovate; a unique learning environment where students can transform their ideas into reality through experimentation, innovation and design. This unit of applied research can engage and publish the research work of the University in certain periodicals that are followed by the relevant department. The unit would offer a multidisciplinary approach to artistic and scientific research, as well as be fruitful in the further internationalization of the program.
3. In general, External evaluation group declares that the basic and auxiliary literature, for each subject of the Master of Arts in Graphic Painting and Teacher Study Program, is provided in the program (syllabus) of each subject. The library as presented to us during the visit had basic and auxiliary literature as provided in accordance with the FAB Regulations. Students are given access to the subject literature according to the prescribed forms. Despite the fact that the department and the institution have included in their strategic plan, the improvement of teaching through the updated literature of the last 5 years, External evaluation group recommends the continuous support of the purchase of literature presented according to the requirements of the pedagogical staff, based on the relevant field. During the visit to the institution, based on discussions with the staff, the purchase of literature in some cases was not possible, which is influenced and dictated by the legal procedures for the purchase of books.



4. Taking into account the specific nature of the Master of Arts Study Program in Graphic Painting and Teacher, as in the organizational side of teaching at FAB, the spaces necessary for the development of the teaching process enable a greater number of students to be present. In general, FAB as an institution has enough spaces to respond to the teaching load. Despite this, it is recommended to increase the spaces or erect a new institutional building, since some of them are already depreciated. Taking into account the growing trend of student registration in this field, the addition of spaces comes as a necessity. The structural requalification of the building has so far been erected and renovated continuously with the contribution of the institution itself



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				

